

**RAPORTI I MONITORIMIT
TË ZBATIMIT TË DETYRIMEVE
LIGJORE TË SIGURIMIT TË
TRANSPARENCËS DHE PROCESIT
TË KONSULTIMIT PUBLIK
NGA BASHKITË**

Dhjetor 2022



Përmbajtja

HYRJE	4	METODOLOGJIA	25
PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE GJATË VITIT 2021	5	PREMTIMET E MONITORUARA.....	26
TRANSPARENCA	5	GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE.....	28
METODOLOGJIA	5	Bashkia Rrogozhinë	28
PARASHIKIMET LIGJORE TË INDIKATORËVE TË MONITORUAR.....	6	Bashkia Lushnje.....	28
GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE.....	9	Bashkia Dibër.....	28
Bashkia Lushnje.....	9	Bashkia Shkodër	29
Bashkia Rrogozhinë	10	Bashkia Lezhë	29
Bashkia Lezhë	12	Bashkia Krujë	29
Bashkia Kurbini	13	Bashkia Kurbini	30
Bashkia Shkodër	15	Bashkia Vorë	30
Bashkia Dibër	16	Bashkia Durrës.....	30
Bashkia Krujë	17	Bashkia Shijak.....	31
Bashkia Vorë	19	ANALIZË KRAHASIMORE E BUXHETEVE TË BASHKIVE TË MONITORUARA	32
Bashkia Durrës.....	20	VEPRIMTARITË E NDALUARA NGA KODI ZGJEDHOR.....	33
Bashkia Shijak.....	22	NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLEVE VENDORE RINORE.....	43
ANALIZË KRAHASUESE.....	24	ANEKS 1	55
MONITORIMI I PREMTIMEVE	25		

HYRJE

Projekti “40 premtime, 10 bashki” është i mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED) dhe është implementuar nga Qendra Faktoje. Synimi i këtij projekti është monitorimi i bashkive sa i përket mbajtjes së premtimeve dhe transparencës. Gjatë këtij viti projekti përfshiu bashkitë e Shkodrës, Lezhës, Dibrës, Durrësit, Vorës, Rrogozhinës, Lushnjes, Shijakut, Krujës dhe Kurbinit të cilat u monitoruan nga gazetarë lokalë si edhe aktivistë të shoqërisë civile. Gjashtë nga këto bashki janë përzgjedhur pasi u bënë pjesë e zgjedhjeve të pjesshme vendore të zhvilluara në mars 2022 dhe katër bashki të tjera janë monitoruar si bashki të përfshira në procesin e rindërtimit pas tërmetit të vitit 2019.

Metodologjia e ndjekur për implementimin e këtij projekti është e njëjtë me metodologjinë e përdorur gjatë vitit të shkuar. Për secilën nga bashkitë janë përzgjedhur 4 premtime të bëra nga kryebashkiakët aktuale. Këto premtime u monitoruan në bazë të një metodologjie analitike që përfshinte analizën buxhetore, monitorimin e prokurimit publik dhe vëzhgimet në terren. Gjithashtu raporti ka monitoruar edhe programin e transparencës, detyrim ligjor i Bashkive që rrjedh nga legjislacioni i qeverisjes vendore, legjislacioni i konsultimit publik dhe ligji për të drejtën e Informimit. Nga ana tjetër, transparenca dhe konsultimi publik janë të rregulluara nga kuadri ligjor dhe nënligjor i

Shqipërisë. Duke qenë se në bazë të legjislacionit vendas, çdo institucion publik duhet të zbatojë programin e transparencës, projekti ka monitoruar se sa ky program zbatohet nga bashkitë e përfshira në projekt.

Ky raport i rifreskuar synon që të përcjellë të dhëna lidhur me monitorimin e zbatimit të këtyre parashikimeve nga dhjetë bashki të vendit. Në raport do të gjeni metodologjinë e përdorur, gjetjet e detajuara të secilës prej bashkive dhe disa rekomandime për përmirësimin sa i përket llogaridhënies dhe zbatimit të parashikimeve ligjore në lidhje me transparencën.

Ky raport ndahet në pesë kapituj. Kapitulli i parë lidhet me indeksin e transparencës. Kapitulli i dytë me mbajtjen e premtimeve nga ana e kryetarëve të bashkive. Kapitulli i tretë ka të bëjë me një analizë krahasimore të buxheteve të këtyre bashkive për disa programe buxhetore. Kapitulli i katërt lidhet me veprimtaritë e ndaluara nga Kodi Zgjedhor, ndërsa Kapitulli i pestë lidhet me ngritjen dhe funksionimin e Këshilleve Vendore Rinore.

Faktoje ka monitoruar bashkite gjatë vitit 2020 dhe gjatë vitit 2021. Në këto linqe gjeni raportet përkatëse për vitin 2019-2020 dhe për vitin 2021-2022 ju ndihmojnë të keni një pamje më të qartë gjithashtu për sa i përket zbatimit të kuadrit ligjor mbi transparencën, por edhe mbi mbajtjen e premtimeve.

RAPORTI 2022

TRANSPARENCA

METODOLOGJIA


Detyrimet e njësive të vetëqeverisjes vendore që lidhen me procesin e konsultimit publik dhe zbatimin e transparencës janë identifikuar nëpërmjet analizës së kuadrit ligjor përkatës. Organizimi dhe funksionimi i njësive të vetëqeverisjes vendore është i rregulluar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndërsa detyrimet e tyre për procesin e konsultimit publik dhe zbatimin e transparencës rregullohen më tej nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, siguron disiplinë fiskale, politika të qëndrueshme dhe transparente për menaxhimin e fondeve publike, dhe parashikimin realist të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore.

Normativa ligjore përsa i përket transparencës në njësitë e pushtetit vendor është plotësuar më tej me Urdhërin nr.211, dt. 20.09.2018, të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ku përcaktohet “Programi Model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, duke detajuar më tej detyrimet e organeve të pushtetit vendor për të siguruar transparencë dhe informim të publikut. Nga parashikimet e këtyre tre ligjeve janë gjeneruar edhe 16 indikatorët për të cilat janë monitoruar dhjetë bashkitë e vendit:

- **INDIKATORI 1:** Caktimi dhe publikimi i një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik,

i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik;

- **INDIKATORI 2:** Konsultimi i buxhetit vjetor të bashkisë;
- **INDIKATORI 3:** Konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore;
- **INDIKATORI 4:** Konsultimi i tjetërsimit të pronave të bashkisë;
- **INDIKATORI 5:** Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 6:** Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 7:** Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 8:** Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 9:** Përcaktimi dhe publikim i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;
- **INDIKATORI 10:** Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të bashkisë;



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- **INDIKATORI 11:** Publikimi i strukturës organizative të bashkisë;
- **INDIKATORI 12:** Publikimi i buxhetit vjetor të bashkisë;
- **INDIKATORI 13:** Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak;
- **INDIKATORI 14:** Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak;
- **INDIKATORI 15:** Publikimi i urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë;
- **INDIKATORI 16:** Publikimi në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike i raporteve të zbatimit të buxhetit.

Të dhënat e këtij raporti për monitorimin e 16 indikatorëve janë mbledhur nga gazetarët në terren. Gazetarët zhvilluan paraprakisht takime informuese me ekspertët të cilët punuan me identifikimin e indikatorëve dhe ekspertin ligjor, për t'u informuar dhe për të marrë shpjegimet përkatëse për të gjithë indikatorët, bazën ligjore të tyre dhe mënyrën e monitorimit. Pas këtij procesi informues dhe sqarues me gazetarët, këta të fundit duke pasur informacionin e duhur mbi indikatorët, mbi parashikimet ligjore të detyrimeve të bashkive për realizimin e tyre dhe burimet nga mund të marrin informacion për secilin prej tyre, kanë analizuar faqet zyrtare të internetit të bashkive dhe kanë monitoruar stendat e njoftimeve publike të bashkive, si një mënyrë tjetër alternative që përdorin bashkitë për komunikimin me qytetarët. Gjithashtu gazetarët kanë ndjekur drejtëpërdrejtë mbledhjet e këshillit bashkiak, fizikisht dhe/ose online sipas rasteve përkatëse. Një burim tjetër i përdorur nga gazetarët për mbledhjen e të dhënave është komunikimi i drejtëpërdrejtë me bashkinë, duke kërkuar informacion.

Përveç këtij monitorimi të gazetarëve, bashkive të monitoruara i është dërguar shkresë zyrtare në

dt. 5 dhjetor 2022 duke i kërkuar informacionin dhe dokumentacionin përkatës për indikatorët e mësipërm të cilat lidhen me konsultimin e akteve të miratuara dhe njoftimet që duhet të realizohen në kuadër të zhvillimit të konsultimit publik për to. Pavarësisht detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 15, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku parashikohet se institucionet duhet të kthejnë përgjigje brenda 10 ditëve pune nga dita e dorëzimit të kërkesës, asnjë prej bashkive nuk u përgjigj.¹


Për të bërë një renditje të bashkive të përfshira në projekt sa i përket transparencës, për secilin nga indikatorët e sipër-përmendur bashkive u është alokuar nga 1 pikë për një total prej 16 pikësh për bashkitë që plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore.

PARASHIKIMET LIGJORE TË INDIKATORËVE TË MONITORUAR

Indikatorët e monitoruar për dhjetë bashkitë e vendit janë gjeneruar nga parashikimet ligjore përkatëse të cilat rregullojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, procesin e konsultimit publik dhe transparencën. Konkretisht janë Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Ligji Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Ligji Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" rregullon procesin e konsultimit publik, për të siguruar transparencën, gjithëpërfshirjen dhe realizimin në kohë të veprimeve. Ky konsultim publik, për të siguruar përfshirjen në procesin e vendimmarrjes zhvillohet për projektakte si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik. Parashikimet ligjore të parashikuara në këtë ligj, zbatimi i të cilave janë monitoruar për bashkitë janë konkretisht:

¹ Shkresa e dërguar gjendet bashkëlidhur këtij Raporti në Aneksin 1.



- Caktimi dhe publikimi i një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik²;
- Konsultimi i buxhetit vjetor të bashkisë³
- Konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore⁴
- Konsultimi i tjetërsimit të pronave të bashkisë⁵
- Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁶
- Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁷
- Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së

mbledhjeve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁸

- Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁹

Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Parashikimet ligjore të parashikuara në këtë ligj, zbatim i të cilave janë monitoruar për bashkitë janë konkretisht:

- Përcaktimi dhe publikim i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit¹⁰
- Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të bashkisë¹¹

² “Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ky ligj”, Neni 10, ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

³ “Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdeklarimeve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik”, Neni 1, ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Detyrimi për këtë këshillim e konsultim buron edhe nga parashikimet e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht nenet 18 dhe 54 të këtij ligji.

⁴ Po aty

⁵ Po aty

⁶ “Njoftimi për projektaktet që do t’i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme: a) me postë elektronike; b) me lajmërim publik, i cili afshohet në ambientet e organit publik inicues; c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale; ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar. 2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike”. Neni 1, ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”


⁷ Po aty

⁸ “Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes”, neni 17, ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Përveç parashikimit në këtë ligj, dy indikatorët e fundit janë analizuar edhe në këndvështrimin e zhvillimit të konsultimit publik, ku nëpërmjet mbledhjeve të këshillit bashkiak e komisioneve, bashkia këshillohet me qytetarët

⁹ Neni 54 i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikon se Këshilli bashkiak zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet. Komisioni si një nga strukturat e këshillit bashkiak ka të njëjtat detyrime kundrejt qytetarëve të njësisë, për më tepër që këshilli bashkiak ka për detyrë këshillimin me bashkësinë për krijimin e këtyre komisioneve sipas parashikimeve të neneve 18 dhe 54/a të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

¹⁰ “Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit”, Neni 10, ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

¹¹ “Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik; b) tekstet e plota... të akteve nënligjore; e) të dhëna për buxhetin”, Neni 7, ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- Publikimi i strukturës organizative të bashkisë¹²
- Publikimi i buxhetit vjetor të bashkisë¹³
- Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak¹⁴
- Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak¹⁵
- Publikimi i urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë¹⁶

¹² Po aty

¹³ Po aty

¹⁴ Po aty. Zbatimi i parashikimeve të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” referohet për detyrimin e publikimit të akteve të këshillit bashkiak drejtëpërdrejtë nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 18. Në këtë nen parashikohet gjithashtu se aktet e këshillit bashkiak publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike.

¹⁵ Po aty


¹⁶ Po aty

GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE

BASHKIA LUSHNJE

Për Bashkinë Lushnje janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkise për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Lushnje e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Lushnje nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit nuk ka shënuar adresën e emailit dhe numrin e telefonit e koordinatorit.	✗
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Lushnje e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Lushnje e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lushnje e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Lushnje ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik, si në rastin e konsultimeve për buxhetin dhe paketen fiskale 2023.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lushnje e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2023 të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor 2023 të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Lushnje e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj, duke theksuar se gjatë vitit 2021 nuk ka pasur tjetërsime pronash prandaj po e cilësojmë si indikator të realizuar.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Lushnje nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Lushnje nuk ka vendosur në faqen e internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✗



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Lushnje nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lushnje nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lushnje nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak. Ndonëse seksioni shfaqet në faqen zyrtare të internetit, kur klikohet nuk të krijon akses në këto vendime.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Lushnje nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Lushnje nuk ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		50%


BASHKIA RROGOZHINË

Për Bashkinë Rrogozhinë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkise për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Rrogozhinë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Rrogozhinë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit nuk ka shënuar adresën e emailit dhe numrin e telefonit të koordinatit.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Rrogozhinë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Rrogozhinë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Rrogozhinë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve. Në faqen e internetit gjenden vetëm buxhetet e viteve 2017-2020.	



6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Rrogozhinë nuk ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✗
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Rrogozhinë nuk e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2022 të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, nuk janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë. Kërkesës për informacion Bashkia iu përgjigj se ka realizuar konsultime publike, por nuk vendosi në dispozicion asnjë provë për realizimin e tyre.	✗
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Rrogozhinë nuk e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktivitetsh për përmbushjen e këtij detyrimi. Kërkesës për informacion Bashkia iu përgjigj se ka realizuar konsultime publike, por nuk vendosi në dispozicion asnjë provë për realizimin e tyre.	✗
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitetsh për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj duke konfirmuar mos tjetërsimin e pronës, prandaj po e cilësojmë si indikator të realizuar.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Rrogozhinë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Rrogozhinë ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Rrogozhinë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Rrogozhinë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✗
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Rrogozhinë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Rrogozhinë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	✗
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Rrogozhinë nuk ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	✗
17	Totali i Realizimit		43.7%




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA LEZHË

Për Bashkinë Lezhë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkise për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinorit.	✓
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik, si në rastin e konsultimeve për buxhetin dhe paketën fiskale 2023.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2022 të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor 2023 të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Lezhë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj duke theksuar mungesën e tjetërsimit të pronës, prandaj po e cilësojmë si indikator të realizuar.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë. Në faqen e internetit gjendet një listë me numrin dhe titullin e disa urdhërave dhe vendimeve, por këto dokumente nuk mund të aksesohen.	✓
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓




12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	✓
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Lezhë ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	✓
17	Totali i Realizimit		100%

BASHKIA KURBIN

Për Bashkinë Kurbin janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkise për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.


Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Kurbin e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Kurbin nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit nuk ka shënuar adresën e emailit dhe numrin e telefonit të koordinatorit.	✗
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Kurbin e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Kurbin e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Kurbin nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Kurbin nuk ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✗



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE


7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Kurbin nuk e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2023 të Bashkisë.	✗
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Kurbin nuk e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	✗
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj duke theksuar se nuk ka pasur tjetërsim prone prandaj po e cilësojmë si indikator të realizuar.	✗
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Kurbin nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Kurbin ka vendosur në faqen e internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Kurbin nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✗
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kurbin nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✗
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kurbin e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Kurbin nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	✗
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Kurbin nuk ka publikuar raporte mbi zbatimin e buxhetit.	✗
17	Totali i Realizimit		37.5%



BASHKIA SHKODËR

Për Bashkinë Shkodër janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkise për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinorit.	✓
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë, megjithëse vetëm në stendë dhe jo në webpage.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2022 të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Shkodër e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka plotësuar këtë kërkesë ligjore.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✓
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendë, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Shkodër ka publikuar raporte mbi zbatimin e buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		100%

BASHKIA DIBËR

Për Bashkinë Dibër janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkise për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinitorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit nuk ka shënuar adresën e emailit dhe numrin e telefonit e koordinitorit.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë, megjithëse vetëm në stendë dhe jo në ëebpage.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2022 të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Dibër e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj duke theksuar mungesën e tjetërsimit të pronave, prandaj po e cilësojmë si indikator të realizuar.	




10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Dibër nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka vendosur në stendë, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Dibër nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✗
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	✓
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Dibër ka publikuar raporte mbi zbatimin e buxhetit.	✓
17	Totali i Realizimit		75%

BASHKIA KRUIJË

Për Bashkinë Krujë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkise për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.


Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Krujë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Krujë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinatorit.	✓
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Krujë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Krujë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë, megjithëse vetëm në stendë dhe jo në webpage.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Krujë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE


6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Krujë ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Krujë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2022 të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Krujë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia nuk iu përgjigj, prandaj po e cilësojmë si indikator të parealizuar.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Krujë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Krujë ka vendosur në stendë dhe në faqen e internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Krujë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Krujë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Krujë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Krujë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Krujë ka publikuar raporte të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		68.7%



BASHKIA VORË

Për Bashkinë Vorë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkise për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Vorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Vorë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit nuk ka shënuar adresën e emailit dhe numrin e telefonit e koordinatorit.	✗
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Vorë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Vorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë, megjithëse vetëm në stendë dhe jo në webpage.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Vorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Vorë ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Vorë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2022 të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Vorë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitetsesh për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht. Bashkia mund të mos ketë realizuat tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj duke theksuar se nuk ka pasur tjetërsim prone, prandaj po e cilësojmë si indikator të realizuar.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Vorë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Vorë nuk ka vendosur në stendë dhe në faqen e internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak. Kërkesës për informacion, Bashkua iu përgjigj duke theksuar se këto njoftime janë bërë në rrjetin social Facebook, i cili sidoqoftë nuk është një kanal zyrtar informacioni.	✗
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Vorë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✗



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Vorë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Vorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Vorë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Vorë nuk ka publikuar të dhëna mbi zbatimin e buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		56.3%


BASHKIA DURRËS

Për Bashkinë Durrës janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkise për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Durrës nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit nuk ka shënuar adresën e emailit dhe numrin e telefonit të koordinatit.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë, megjithëse vetëm në stendë dhe jo në ëebpage.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2022 të Bashkisë.	



8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Durrës e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitesh për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj duke theksuar se nuk ka pasur tjetërsim prone, prandaj po e cilësojmë si indikator të realizuar.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Durrës nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në stendë dhe në faqen e internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	✗
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Durrës nuk ka publikuar raporte të zbatimit të buxhetit. Në faqen e internetit mund të gjenden vetëm raportet e vitit 2018.	✗
17	Totali i Realizimit		75%




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA SHIJAK

Për Bashkinë Shijak janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkise për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Shijak e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Shijak nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit nuk ka shënuar adresën e emailit dhe numrin e telefonit e koordinatorit.	✗
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Shijak e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Shijak e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë, megjithëse vetëm në stendë dhe jo në webpage.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shijak e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Shijak ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shijak e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2022 të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Shijak e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj duke theksuar mungesën e tjetërsimit të pronave, prandaj po e cilësojmë si indikator të realizuar.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Shijak nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Shijak ka vendosur në stendë dhe në faqen e internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Shijak ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓



13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shijak nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shijak e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo setendën e njoftimeve publike	Bashkia Shijak nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	✓
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Shijak ka publikuar raporte mbi monitorimin e buxhetit.	✓
17	Totali i Realizimit		87.5%

ANALIZË KRAHASUESE

Në tabelën më poshtë janë përmbledhur rezultatet e monitorimit për të pesëmbëdhjetë bashkitë e monitoruara, të renditura sipas rezultatit në indeksin e transparencës. Vlen të theksohet që në fillim se në dhjetë bashkitë e monitoruara gjatë vitit të shkuar, vetëm një prej tyre ka përqesim të treguesve të transparencës. Dy bashki kanë ruajtur të njëjtin nivel transparence, ndërsa shtatë bashki janë bërë më transparente se një vit më parë.

Bashkia me performancën më të lartë janë ajo e Shkodrës dhe Lezhës me 100% ndjekur nga Bashkia e Shijakut e cila ka realizuar kërkesat e legjislacionit sa i përket transparencës në masën 87.5% duke realizuar 14 nga 16 indikatorët e matur. Ndërkohë, Bashkia me performancën më të dobët është Bashkia e Kurbinut niveli i transparencës së të cilës është vetëm 37.5%.

Sa u përket indikatorëve, vërehet se pothuajse të gjitha bashkitë e monitoruara e kanë publikuar Programin e Transparencës në faqen e tyre të internetit. Ndërkohë, të gjitha bashkitë e monitoruara kanë caktuar dhe publikuar të dhënat për Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, edhe pse vetëm 3 nga 10

bashkitë e monitoruara, kanë caktuar Koordinatorin për Konsultimin Publik.

Bashkitë kanë një performancë të mirë në konsultimin publik të Buxhetit Vjetor dhe në publikimin e tij në faqen e internetit. Në këtë mënyrë, 9 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë realizuar konsultime publike për hartimin e buxhetit dhe e kanë publikuar buxhetin vjetor. Performanca është e njëjtë sa i përket konsultimeve me publike për paketën e taksave dhe tarifave vendore ku 8 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë zhvilluar konsultime publike për këtë çështje.

Sa i përket transparencës së Këshillit Bashkiak, 7 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë njoftuar datën dhe orën e Mbledhjes së Këshillit, Bashkiak. Vetëm 4 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë publikuar Proces-Verbalet e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Nga ana tjetër, 9 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë publikuar Vendimet e Këshillit Bashkiak.

Transparenca është shumë e ulët sa i përket publikimit të Vendimeve dhe Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë. Vetëm 2 nga 10 bashkitë e monitoruara i kanë publikuar urdhërat apo vendimet e Kryetarit.

Nr	Bashkia	Indeksi i Transparencës
1	Bashkia Shkodër	100%
2	Bashkia Lezhë	100%
3	Bashkia Shijak	87.5%
4	Bashkia Dibër	75%
5	Bashkia Durrës	75%
5	Bashkia Krujë	68.7%
7	Bashkia Vorë	56.3%
8	Bashkia Lushnje	50%
9	Bashkia Rrogozhinë	43.7%
10	Bashkia Kurbin	37.5%

MONITORIMI I PREMTIMEVE

Ekipi i Faktoje përzgjedhi katër premtime të bëra gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e pjesshme vendore 2022, ose gjatë mandatit të tyre si kryetar bashkie deri në zgjedhjet vendore maj 2023, si dhe premtime që lidhen me procesin e rindëtimimit për bashki të prekura nga tërmeti i viti 2019. Për monitorimin e këtyre premtimeve është ndjekur metodologjia e mëposhtme:

METODOLOGJIA

Premtimet për shërbimet publike mund të ndahen në dy grupe të mëdha:

- 1 Premtimet që lidhen me aktet administrative mbi uljen apo heqjen e taksave e tarifave apo për kthimin e një hapësire publike në pedonale, apo për hapjen e një qendre sociale, kinemaje, etj.

Mbajtja e këtyre premtimeve realizohet përmes miratimit të akteve administrative ligjore si Vendimet dhe Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak. Disa prej këtyre premtimeve kanë edhe efekte financiare dhe për këtë duhet analizuar edhe buxheti për të parë nëse janë parashikuar fonde për ngritjen e një strukture të re;


- 2 Premtimet që lidhen kryesisht me infrastrukturën publike që përbëjnë detyrat dhe kompetencat kryesore të bashkive si ujësjellësi dhe kanalizimet, rrugët dhe hapësirat e gjerlbërta,

shkollat dhe kopështet, qendrat shëndetësore, qendrat sociale dhe godinat e tjera publike, etj. Mbajtja e këtyre premtimeve lidhet ngushtësisht me buxhetin e bashkive.

Për të analizuar dhe dokumentuar mbajtjen e këtyre premtimeve fillimisht duhet parë nëse ato janë përfshirë buxhetin e Bashkisë, më saktësisht në "Shpenzimet Kapitale" apo në "Shpenzimet e Mirëmbajtjes".

Megjithatë, edhe nëse janë përfshirë në buxhet, nuk do të thotë se premtimet do të mbahen pasi bashkitë pothuajse gjithmonë nuk i përmbahen angazhimeve të buxhetit. Prandaj është me rëndësi që të shihet edhe nëse një bashki ka bërë ose planifikon të bëjë prokurimin publik për projektin në fjalë. Plani i prokurimeve mund të shihet në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Vlen të theksohet se realizimi i disa prej këtyre premtimeve mund të bëhen edhe në bashkëpunim apo me ndihmën e institucioneve të tjera, si Ministritë e Linjës, psh, Ministria e Shëndetësisë për qendrat shëndetësore apo AKUM për ujësjellësat apo landfillet. Prandaj është e rëndësishme që të studiohen edhe buxhetet dhe prokurimet e këtyre institucioneve për të parë nëse e kanë përfshirë këtë projekt apo jo. Si rrethim, në bazën e të dhënave parashikohet të ekzistojë edhe seksioni "Institucion tjetër i përfshirë" për të identifikuar dhe monitoruar edhe këto institucione që mund të financojnë plotësisht apo bashkë-financojnë me bashkitë implementimin e këtyre projekteve.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

Indikatorët që propozohet të maten, sa u takon Shërbimeve Publike, janë:

- 1 Vendimet dhe Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë;
- 2 Vendimet e Këshillit Bashkiak;
- 3 Buxheti;
- 4 Plani i Prokurimeve;
- 5 Lista e Kontratave të Shpallura;
- 6 Buxheti i Institucioneve të tjera të Përfshira dhe plani i tyre i prokurimeve.

PROJEKTET E MËDHA

Projektet e mëdha përfshijnë projekte që kërkojnë një financim shumë të madh krahasuar me buxhetin e bashkie dhe kërkojnë domosdoshmërisht përfshirjen dhe financimet e Qeverisë Qendrore. Në këto projekte përfshihen Autostradat dhe Rrugët Kombëtare, Portet, Aeroportet dhe Terminale, Spitalet, Teatrot, Stadiumet, etj.

Këto projekte, pavarësisht se mund të jenë premtuar nga Kryebashkiakët, faktikisht janë jashtë kompetencave të Bashkisë. Por, premtimi i kryetarëve mund të lidhet edhe me lobimin pranë Qeverisë apo Ministrive për financimin e këtyre projekteve. Prandaj, për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve duhet të monitorohet buxheti dhe plani i prokurimeve i institucionit qendror e jo i bashkisë.

Indikatorët që propozohet të maten, sa u takon Projekteve të Mëdha, janë:

- ◆ Buxheti i Institucioneve qendrore në varësi të fushës, si psh. Ministrisë së Shëndetësisë për Spitalet, FSHF/MASR për Stadiumet, FSHZH apo ARRSH për rrugët, etj.

Për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve, Ekipi i Faktoje ndërmorri hapat e mëposhtme:

- 1 Analiza e buxhetit të bashkive;
- 2 Analiza e Planit të Prokurimeve;
- 3 Dërgimi i kërkesave për informacion pranë bashkive;
- 4 Realizimi i vizitave në terren për të parë gjendjen nga afër.

PREMTIMET E MONITORUARA

Premtimet e përzgjedhura për secilën nga Bashkitë e përfshira në projekt janë si më poshtë.

BASHKIA RROGOZHINË


- ◆ Ndërtimi i ujës-jellës në Sinaballaj;
- ◆ Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Qamil Gjuzi";
- ◆ Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare në Lekaj;
- ◆ Argjinaturat e lumit Shkumbin.

BASHKIA LUSHNJË

- ◆ Ndërtimi i pritës lumore në Thanasaj;
- ◆ Asfaltimi i disa segmenteve rrugore;
- ◆ Ndërtimi i unazës së madhe të Myzeqesë;
- ◆ Rikonstruksioni i Përroit të Qytetit.

BASHKIA DIBËR

- ◆ Ndërtimi i trotuareve;
- ◆ Mbyllja e vend-depozitimit të mbetjeve në Peshkopi;
- ◆ Asfaltimi i rrugës "Iliaz Pashë Dibra";
- ◆ Rehabilitimi i fasadave të pallateve në Peshkopi.

**BASHKIA SHKODËR**

- ◆ Lirimi i hapësirave publike;
- ◆ Strehëza për kafshët endacake;
- ◆ Evitimi i përmytjeve në Bërdicë;
- ◆ Rehabilitimi i Rrugëve "Qafa e Bishkazit,, dhe në Lagjen "Dragushej,,.

BASHKIA DURRËS

- ◆ Hapja e eco-parkut në date 1 qershor 2022;
- ◆ Riparimi brenda 6 muajve i 103 pallateve të shkallës DS4;
- ◆ Rikonstruksioni i rrugës "Aleksandër Goga";
- ◆ Nisja e punimeve për shëtitoren bregdetare;

BASHKIA LEZHË

- ◆ Rindërtimi i pallatit 88 në lagjen Skanderbeg;
- ◆ Rikonstruksioni i konviktit të shkollës profesionale "Kolin Gjoka,,;
- ◆ Ndërtimi i 80 apartamenteve të reja në kuadër të rindërtimit;
- ◆ Vendosja e 39 kamerave të sigurisë në Shëngjin.

BASHKIA SHIJAK

- ◆ Ndërtimi i 3 pallateve për të pastrehët;
- ◆ Dhënia e çertifikateve të pronësisë për banesat individuale;
- ◆ Ndërtimi i Pallatit të Kulturës;
- ◆ Rindërtimi i pallateve.

BASHKIA KRUJË

- ◆ Prishja/demolimi i pallateve të dëmtuara nga tërmeti dhe nisja e rindërtimit;
- ◆ Ndërtimi i 13 objekteve arsimore për vitin e ri shkollor;
- ◆ Ndërtimi i ujësjellësit të Krujës dhe Fushë-Krujës;
- ◆ Zgjerimi i rrugës së Spitalit në Krujë.

BASHKIA KURBIN

- ◆ Pastrimi i Kanaleve Kulluese;
- ◆ Disbursimi dhe dëmshpërblimi me grantet e rindërtimit;
- ◆ Rindërtimi i godinës së Bashkisë;
- ◆ Rindërtimi i Shkollës Gjon Gjonaj.

BASHKIA VORË

- ◆ Rindërtimi i kopështit publik;
- ◆ Hapja e dy shkollave të reja 9-vjeçare;
- ◆ Shtrimi i Rrugës së fshatit Bërxullë;
- ◆ Rindërtimi i banesave individuale;

GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE

BASHKIA RROGOZHINË


Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i ujësjellësit në Sinaballaj;	Ujësjellësi është ndërtuar por cilësia e ujit nuk është e mirë, çka e bën atë jo të pishëm.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare „Qamil Gjuzi“;	Punimet për rindërtimin e shkollës kanë nisur dhe parashikohet të përfundojnë në Prill 2023.	Premtim i mbajtur
Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare në Lekaj;	Punimet për rindërtimin e shkollës faktikisht kanë nisur, por ato duhet të përfundonin në Korrik 2022.	Premtim i pambajtur
Argjinaturat e lumit Shkumbin.	Nga vizita në terren, nuk rezultojnë se argjinaturat përgjatë brigjeve të Shkumbinit janë ndërtuar, ndonëse Bashkia pretendon të kundërtën.	Premtim i pambajtur

BASHKIA LUSHNJE

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i pritës lumore në Thanasaj;	Prita lumore është ndërtuar, edhe pse jo brenda afateve të premtuara gjatë fushatës elektorale	Premtim i mbajtur
Asfaltimi i disa segmenteve rrugore;	Punimet në një sërë segmentesh rrugore kanë nisur, por përfundimi i tyre i ka kaluar tashmë afatet kontraktuale.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i unazës së madhe të Myzeqesë;		Premtim pjesërisht i mbajtur
Rikonstruksioni i Përroit të Qytetit.		Premtim pjesërisht i mbajtur

BASHKIA DIBËR

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i trotuareve;	Bashkia deklaron se këtë premtime e ka në listën e saj të prioriteteve, por nga vëzhgimi në terren rezultojnë se punimet ende nuk kanë nisur.	Premtim i pambajtur
Mbyllja e vend-depozitimit të mbetjeve në Peshkopi;	Vend-depozitimi është ende i hapur. Kërkesës tonë për informacion Bashkia iu përgjigj se ishte ende në fazën e vlerësimit teknik dhe financiar.	Premtim i pambajtur
Asfaltimi i rrugës “Iliaz Pashë Dibra”;	Rruga është e asfaltuar dhe tërësisht funksionale.	Premtim i mbajtur
Rehabilitimi i fasadave të pallateve në Peshkopi.		Premtim pjesërisht i mbajtur

**BASHKIA SHKODËR**


Premtimi	Komente	Statusi
Strehëza për kafshët endacake;	Strehëza është në ndërtim e sipër, edhe pse përfundimit të punimeve u ka kaluar afati.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Lirimi i hapësirave publike;	Vëzhgimi në terren nga Faktore tregoi se hapësirat publike nuk janë liruar e në to zhvillohen një sërë aktivitetesh ekonomike informale.	Premtim i pambajtur
Evitimi i përmbytjeve në Bërdicë;	Bashkia pranon se në këtë zone nuk është kryer asnjë investim.	Premtim i pambajtur
Rehabilitimi i Rrugëve Qafa e Bishkazit dhe në Lagjen Dragushej.	Ndonëse investimi ka përfunduar, cilësia e punimeve lë për të dëshiruar, duke shkaktuar më shumë probleme nga sa synohej të zgjidhte.	Premtim pjesërisht i mbajtur

BASHKIA LEZHË

Premtimi	Komente	Statusi
Rindërtimi i pallatit 88 në lagjen Skanderbeg;	Sipas bashkisë pallati do të ndërtohet nga një fondacion por nuk bën publik asnjë informacion në lidhje me kur do të fillojnë punimet.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rikonstrukcioni i konviktit të shkollës profesionale "Kolin Gjoka";	Godina është ndërtuar dhe është funksionale, megjithse ajo është hapur vetëm pasi viti akademik kishte nisur.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Ndërtimi i 80 apartamenteve të reja në kuadër të rindërtimit;	Apartamentet janë ndërtuar dhe banorët kanë marrë çelësat.	Premtim i mbajtur
Vendosja e 39 kamerave të sigurisë në Shëngjin dhe Lezhë.	Ndonëse në Shëngjin kamerat janë vendosur, në Lezhë ende nuk ka nisur puna.	Premtim pjesërisht i mbajtur

BASHKIA KRUIJË

Premtimi	Komente	Statusi
Prishja/demolimi i pallateve të dëmtuara nga tërmeti;	Nga vëzhgimi në terren rezulton se pallatet janë shëmbur plotësisht çka po vonon procesin e rindërtimit, por bashkia nuk jep informacione për Siti 4	Premtim i mbajtur
Ndërtimi i 13 objekteve arsimore për vitin e ri shkollor;	Vizita në terren dëshmoi se shkollat janë ndërtuar e janë funksionale.	Premtim i mbajtur
Ndërtimi i ujësjellësit të Krujës dhe Fushë-Krujës;	Punimet kanë përfunduar por furnizimi me ujë nuk bëhet 16 orë në ditë dhe cilësia e ujit nuk është e standarteve që do ta bënin të pijshëm.	Premtim i mbajtur
Zgjerimi i rrugës së Spitalit të Krujës	Vizita tregoi se nuk ka asnjë shenjë për nisjen e një projekti të tillë, madje banorët as që kanë dijeni për këtë gjë.	Premtim i pambajtur



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA KURBIN


Premtimi	Komente	Statusi
Disbursimi dhe dëmshpërblim me grantet e rindërtimit.	Nga vëzhgimi në terren rezulton se asnjë investim nuk është realizuar çka është bërë rrezik për sigurinë e banorëve.	Premtim i pambajtur
Pastrimi i kanaleve kulluese;	Vizita në terren tregoi se kanalet janë ende të papastruar.	Premtim i pambajtur
Rindërtimi i godinës së Bashkisë;	Puna për rindërtimin e Bashkisë ka nisur por afatet për përfundimin e punimeve janë tejkaluar.	Premtim i pambajtur
Rindërtimi i Shkollës Gjon Gjonaj.	Punimet kanë kohë që kanë nisur, por ende skanë përfunduar ndonëse afatet janë tejkaluar.	Premtim i pambajtur

BASHKIA VORË

Premtimi	Komente	Statusi
Rindërtimi i kopshtit publik;	Punimet kanë nisur, por vetëm 2 vjet pas shëmbjes së kopështit të vjetër, dhe ende nuk kanë përfunduar.	Premtim i pambajtur
Shtrimi i rrugës në Bërxullë	Rrugë është në gjendje shumë të keqe dhe asnjë punim për rehabilitimin e saj nuk ka nisur.	Premtim i pambajtur
Hapja e dy shkollave 9-vjeçare	Shkollat janë hapur brenda afateve të deklaruara.	Premtim i mbajtur
Rindërtimi i banesave individuale;	Vizita ne terren tregoi se ka shtepi qe nuk jane shembur dhe ku nuk ka filluar procesi i rindertimit	Premtim i pambajtur

BASHKIA DURRËS

Premtimi	Komente	Statusi
Hapja e eco-parkut në 1 qershor	Ndonëse shumica e punimeve kanë përfunduar, parku ende nuk është i hapur.	Premtim i pambajtur
Riparimi brenda 6 muajve i 103 pallateve të shkallës DS4;	Informacionet konfirmojnë se vetëm 9 pallate janë përforcuar.	Premtim i pambajtur
Rikonstruksioni i Rr. Aleksandër Goga		Premtim i pambajtur
Nisja e punimeve për shëtitoren bregdetare;	Gjatë verifikimit në terren u kostatua se ende nuk kishte nisur puna për rikonstruksionin e rrugës	Premtim i mbajtur

**BASHKIA SHIJAK**

Premtimi	Komente	Statusi
Rindërtimi i pallateve;	Sipas informacioneve, aktualisht janë ndërtuar 26 nga 31 pallatet në proces rindërtimi.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Ndërtimi i 3 pallateve për të pastrehët;	Sipas informacioneve, Enti Kombëtar i banesave ka hapur një procedure prokurimi vetëm për një pallat, dhe punimet ende nuk kanë nisur.	Premtim i pambajtur
Dhënia e çertifikateve të pronësisë për banesat individuale brenda muajit gusht 2021;	Bashkia pranon se shpërndarja nuk ka nisur ende he se përgjegjëse për këtë është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i Pallatit të Kulturës;	Punime kanë nisur, ndonëse 1 vit pas premtimit.	Premtim i mbajtur

ANALIZË KRAHASIMORE E BUXHETEVE TË BASHKIVE TË MONITORUARA

Gjatë këtij viti, pjesë e raportit mbi monitorimin e bashkive ishte menduar të bëhej edhe analiza e buxheteve të tyre të vitit 2023 për të parë nëse këto bashki kanë tentuar të përdorin buxhetet për qëllime elektorale, duke qenë se viti 2023 është vit zgjedhor. Nga dhjetë bashkitë e monitoruara, vetëm 6 e kanë publikuar buxhetin e vitit 2023, ndonëse të gjitha e

kanë miratuar buxhetin përpara nisjes së vitit 2023. Nga këto, buxheti i dërguar nga Bashkia Dibër pas kërkesës për informacion nga Faktoje është i paplotë dhe thuajse i palexueshëm. Rrjedhimisht, duke qenë se dokumenti i buxhetit ishte i disponueshëm vetëm për gjysmën e bashkive të monitoruara, një analizë e tillë do të ishte e paplotë.

ZGJEDHJET LOKALE 2023

VEPRIMTARITË E NDALUARA NGA KODI ZGJEDHOR

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Dekretit nr. 13864 , më 24.10.2022 caktoi datën 14 maj 2023 si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Në shkurt të vitit 2022, Kuvendi vendosi ngritjen e një komisioni parlamentar ad hoc për Reformën Zgjedhore, i cili kishte si objektiv realizimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore sipas rekomandimeve të fundit të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e vitit 2021 dhe kishte një mandat gjashtë mujor. Komisioni u krijua më 17 qershor 2022. Në përfundim të mandatit të tij, në gusht 2022, rezultoi se Komisioni kishte mbajtur vetëm mbledhjen e konstituimit të tij. Në shtator 2022, Komisioni me konsensus politik vendosi të shtyjë me 6 muaj të tjerë afatin, duke qenë se nuk arriti të përmbushë qëllimin për të cilin u ngrit.

Në këto kushte, edhe në zgjedhjet vendore të majit 2023 do të vijojnë të zbatohen parashikimet ligjore ekzistuese të Kodit Zgjedhor.

Më 6 mars 2022, Shqipëria zhvilloi zgjedhje të pjesshme në gjashtë bashki. Presidenti i Republikës dekretoi zgjedhjet e pjesshme më 20 janar 2022, pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese për vlefshmërinë e zgjedhjeve lokale 2019. Zgjedhjet e pjesshme u zhvilluan, për të rizgjedhur Kryetarët e Bashkive, Shkodër, Vorë dhe Lushnjë pas shkarkimit të kryetarëve për arsye të dekrimalizmit, në zbatim të ligjit *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*,


në bashkitë Durrës dhe Dibër kryetarët kishin dhënë dorëheqjen, ndërsa në bashkinë Rrogozhinë kryetari kishte ndërruar jetë.

Njëmbëdhjetë parti politike u regjistruan për të marrë pjesë në zgjedhjet e pjesshme, duke paraqitur 19 kandidatë, nga të cilat tre ishin gra. Votimi dhe numërimi elektronik u pilotua në bashkinë Vorë dhe identifikimi biometrik i votuesve u zbatua në të gjitha qendrat e votimit.

Partia Socialiste fitoi pesë nga gjashtë bashki, ndërsa një koalicion i dy partive opozitare fitoi bashkinë e mbetur. Dy nga gjashtë kryebashkiakë janë gra. Asnjë subjekt zgjedhor nuk i kundërshtoi rezultatet. Të gjithë kryetarët e sapozgjedhur do të jenë në detyrë për gati një vit, pasi zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të planifikuara rregullisht, pritet të mbahen në vitin 2023.

Një sërë raportesh nga organizata ndërkombëtare mbi organizimin dhe menaxhimin e procesit zgjedhor, siç janë Raporti i OSBE/ODHIR, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit si dhe Raporti për Shqipërinë 2022, evidentuan se zgjedhjet përgjithësisht u organizuan mirë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve arriti të përmbushë në mënyrë adekuate shumicën e detyrimeve të tij, duke përfshirë edhe ato të reja komplekse lidhur me identifikimin elektronik të zgjedhësve. Zgjedhjet vendore të 6 marsit 2022, vendosën një gur kilometrik për zgjedhjet në Shqipëri pasi për herë të parë në historinë 30-vjeçare të proceseve zgjedhore pluraliste, rezultati i zgjedhjeve u certifikua pa asnjë kontestim.

Raporti për Shqipërinë 2022 thekson faktin se keqpërdorimi i burimeve shtetërore gjatë fushatave elektorale vijon të mbetet shqetësues. Komisioni



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

Qendror Zgjedhor mori masë administrative me gjobë ndaj kryetares së Bashkisë Durrës për shfrytëzim të burimeve publike gjatë fushatës zgjedhore në zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit 2022. Incidente të tilla dhe të tjera që lidhen me blerjen e votave, praktikat në zgjedhjet e përgjithshme të prillit 2021, konfirmuan nevojën për sigurimin e transparencës përsa i përket financimit të partive politike të cilat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Më 23 korrik 2020 hynë në fuqi ndryshimet e reja në Kodin Zgjedhor. Këto ndryshime, përveç ndryshimeve në aspektin e financimit të partive politike, listave gjysëm të hapura dhe përfshirjes së teknologjisë në zgjedhje, përfshinë edhe ndryshime në aspektin e përdorimit të burimeve shtetërore në mbështetje të subjekteve zgjedhore dhe veprimtarive të institucioneve publike në fushatën zgjedhore, kërkesa këto të artikuluara nga ana e opozitës. Ndryshimet e reflektuara synonin krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që merrnin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe kishin për qëllim kufizimin dhe ndalimin e përdorimit të aseteve, burimeve njerëzore dhe punësimeve, duke e kufizuar për një periudhë katër muaj nga dita e zgjedhjeve. Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, në 24 dhjetor 2020 Komisioni Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nxorri vendimin nr.9 *“Për Rregullat e Raportimit të Veprimtarive të Institucioneve Publike dhe Veprimtaritë e Ndaluar në Fushatë Zgjedhore”*.

Kodi Zgjedhor, përsa i përket aspektit të organizimit institucional ngarkon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si institucion përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, për drejtimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së administratës zgjedhore, monitorimin e veprimtarisë së subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidhjes në rrugë administrative të kërkesave apo ankesave që lidhen me procesin zgjedhor.

Gjithashtu, **Kodi** Zgjedhor parashikon organet drejtuese të KQZ-së, siç janë:


- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, organ monokratik, që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët;
- Komisioni Rregullator si organ kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet si dhe
- Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve si organ kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor.

Ndër kompetencat kryesore të Komisionit Rregullator parashikohet edhe miratimi i projektakteve me karakter normativ për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara përgjatë fushatës, si dhe procedurën e KQZ-së për zbatimin e ndalimit.

Në kuadër të ndalimit të përdorimit të burimeve shtetërore/publike në fushatën zgjedhore, dispozitat e Kodit Zgjedhor parashikojnë:

Neni 91 “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore” (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020)

- Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.
- Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të




parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

- Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirim, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirim nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.
- Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.
- KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike.

Neni 92 “Veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë” (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020)

- Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.
- Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.
- Raportimi sipas pikës 1 të këtij neni kryhet nëpërmjet ndërfaqes për raportimin e veprimtarive publike, e cila mbahet dhe administrohet nga KQZ-ja. Personat përgjegjës marrin akses të personalizuar te kjo ndërfaqe dhe hedhin të dhënat për datën dhe orën e veprimtarisë, llojin e saj, tematikën, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin. Informacioni sipas kësaj pike është i aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit e ndërfaqes nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
- Në rast se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton nga informacioni, sipas pikës 3 të këtij neni, se veprimtaria mund të përbëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron ndalimin e zhvillimit të saj. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

shënimit “Ndaluar nga KQZ-ja” në ndërfaqen e raportimit, në pjesën që i takon veprimtarisë. Shënimi “Ndaluar nga KQZ-ja” vendoset jo më vonë se dy ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Informacioni sipas kësaj pike është i aksesueshëm nga publiku, nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

- Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite.
- Rregullat për shqyrtimin, kryesisht ose me kërkesë, të rasteve që mund të formojnë keqpërdorim të burimeve shtetërore, sipas pikave 1 dhe 4 të këtij neni, miratohen nga KQZ-ja me akt normativ.

Bazuar në parashikimet e mësipërme si dhe kompencave që Kodi Zgjedhor ja ngarkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kontrollin dhe marrjen e masave për parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore në periudhën 4 mujore para zgjedhjeve, Komisioni Rregullator miratoi vendimin nr.9, datë 24.12.2020 ***“Për Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të cdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.***

Ky vendim ka për qëllim sanksionimin e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve publike, qofshin këto burime njerëzore apo financiare dhe logjistike të institucioneve në nivel qendror dhe vendor si dhe të administratës shtetërore gjatë periudhës kohore 4 muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve.


Gjithashtu, ky vendim ka si objekt edhe përcaktimin e rregullave jo vetëm të raportimit të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike qendrore dhe vendore etj, por edhe përcaktimin e kategorive të veprimtarive të ndaluara, procedurat e shqyrtimit të tyre nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për ndalimin e realizimit të tyre si dhe masat administrative që merren në rastet e mosrespektimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor apo dhe vetë këtij akti normativ.

Neni 2, pika b) jep përkufizimin se cilat do të konsiderohen si veprimtari publike. Sipas këtij përkufizimi ***“veprimtari publike” janë të gjitha veprimtaritë publike që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e parashikuara në këtë vendim si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore pra datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.***

Referuar parashikimeve në nenin 3 të këtij vendimi, pika 1.1, sanksionohet se: ***“veprimtari të ndaluara për tu promovuar” konsiderohen ato veprimtari publike për të cilat janë vënë rishtazi në dispozicion apo transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve...***

Cfarë ndalon Kodi Zgjedhor gjatë periudhës së fushatës zgjedhore!

Nëse do të analizojmë këto dy parashikime, rezulton se veprimtaritë publike të ndaluara për tu promovuar do të kanalizohen vetëm në ato veprimtari për të cilat ka “financim rishtazi” apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, duke e kufizuar në periudhën 4 mujore para datës së zgjedhjeve. Kjo do të thotë që veprimtari, të cilat kanë si qëllim mbështetjen dhe promovimin e investimeve infrastrukturore (si psh transport, energjitikë, telekomunikacion, vepra ujore etj), të kryera nga drejtuesit vendorë më së shumti në prag periudhe zgjedhore apo edhe gjatë periudhës zgjedhore, apo mbështetja dhe promovimi i objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi/ rikonstruksioni në kuadër



të procesit të rindërtimit si pasojë e tërmetit të vitit 2019, nuk do të jenë subjekt i këtyre kufizimeve dhe nuk do të konsiderohen si veprimtari të ndaluara për tu promovuar në kuptim të parashikimeve të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr.9/2020.

Një kategori tjetër e veprimtarive të ndaluara në periudhën 4 mujore para zgjedhjeve përfshin edhe:

- Shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimit;
- Shpërndarjen në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, certifikatave të pronësisë, si dhe çfaredolloj tjetër titulli pronësie;
- Vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme për qëllime zgjedhore, në pronësi apo administritim të njësisë të qeverisjes vendore, etj.

Kufizimet e veprimtarive publike filluan zbatimin e tyre në 25 dhjetor 2020. Që prej asaj periudhe, kanë kaluar 2 vjet dhe prezupozohet që ka kaluar kohë e mjaftueshme për të gjithë institucionet dhe kandidatët në zgjedhje për tu njohur me këto parashikime, dhe për ti zbatuar ato duke qenë se tashmë ekziston një praktikë e konsoliduar nga zgjedhjet e përgjithshme.

Panorama shfaqet ndryshe kur diskutojmë për zgjedhjet e pjesshme vendore të 6 marsit 2022. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në rastin e zgjedhjeve të pjesshme vendore u gjend në presion përse i përket afateve dhe pati disa vendimmarrje duke përgjysmuar kohën e fushatës zgjedhore normale nga 30 në vetëm 14 ditë dhe duke vendosur datën 31 janar si limit për raportimin e aktiviteteve me karakter publik të institucioneve shtetërore, në kushtet kur data e zgjedhjeve ishte caktuar data 6 mars.


Referuar parashikimeve ligjore në nenin 4 të vendimit nr.9 për "Rregullat e Raportimit të Veprimtarive të Institucioneve Publike dhe Veprimtaritë e Ndaluara në Fushatë Zgjedhore", raportimi i të gjitha veprimtarive publike është mundësuar nga

ana e KQZ-së nëpërmjet aksesimit të faqes zyrtare të internetit (ndërfaqes së raportimeve) <https://aktivitete.kqz.gov.al>. Informacioni që përmban ndërfaqja është i aksesueshëm lirisht nga publiku i gjerë, vetëm për periudhën nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Raportimi i aktiviteteve nga ana e institucioneve në ndërfaqen e raportimeve parashikohet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë apo të aktivitetit publik.

Në rastet kur Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton se veprimtaria publike përbën veprimtari të ndaluar dhe/ose keqpërdorim të burimeve shtetërore, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit "Ndaluar nga KQZ-ja". Informacioni në lidhje me veprimtaritë e ndaluara organizohet në një rubrikë të veçantë "Veprimtari të ndaluara" në faqen zyrtare të KQZ-së. Nga kontrolli i kryer në këtë faqe, rezulton se nuk ekziston asnjë informacion nëse ka pasur apo jo veprimtari të ndaluara nga e KQZ-së për zgjedhjet e pjesshme vendore të marsit 2022. Kjo tregon se gjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore, asnjë ngjarje nuk është shënuar si e ndaluar nga ana e KQZ-së gjë që vë në diskutim nëse KQZ-ja ka pasur efektivisht mundësinë dhe kapacitetin institucional për të shqyrtuar dhe verifikuar informacionin për të gjitha deklaratimet për veprimtaritë zyrtare në kohë.

Nga ana tjetër, nëni 10 të vendimit nr.9/2020 përcakton vendosjen e sanksioneve administrative me gjobë për institucionet, në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 2 të nenit 3 të Vendimit nr.9/2020, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht apo zhvillojnë veprimtarinë pavarësisht ndalimit të bërë nga KQZ-ja, si dhe vetë titullarin e institucionit në rastet kur ai/ajo ka penguar raportimin, ka ndikuar apo urdhëruar që raportimit të bëhet me vonesë, ka zhvilluar veprimtarinë pavarësisht ndalimit të KQZ-së.

Kodi Zgjedhor parashikon Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) si organin përgjegjës për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkeljet e ligjit zgjedhor.



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

KAS shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit dhe KZAZ-ve. Me kërkesë të Komisionerit vendos masat disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë apo sanksione administrative kundër personave/ subjekteve zgjedhore që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet.

Me qëllim analizimin në terma konkretë të monitorimit të përdorimit të burimeve shtetërore gjatë zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, Qendra "Faktoje" i drejtoi kërkesë për informacion Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nga analizimi i të dhënave statistikore të KQZ-së të përcjella, rezulton se në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë raportuar në total 21 denoncime për hetime administrative. Nga këto 21 denoncime, 5 (pesë) raste lidhen me keqpërdorimin e burimeve shtetërore përgjatë fushatës zgjedhore, përkatësisht 2 (dy) raste në bashkinë Durrës, 1 (një) në Bashkinë Lushnjë dhe 2 (dy) raste në Bashkinë Shkodër.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka konkluduar në vendimmarrje për këto 5 raste si më poshtë vijon:

- Me Vendimin nr. 152 datë 28.04.2022 ka vendosur: Sanksionin administrativ me gjobë ndaj Drejtorit të Shkollës 9- vjeçare "Armath" z. Vlash Doda në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë dhe Sanksionin administrativ me gjobë ndaj kandidatit për kryetar bashkie në bashkinë Durrës, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", zj. Emiriana Sako në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë.
- Me Vendimin nr. 167 datë 19.05.2022 ka vendosur: Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj z. Pirro Vengu Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Portual Durrës, zj. Emiriana Sako Kryetar i Bashkisë Durrës, z. Klevis Hysa Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit dhe zj. Kseanela Sotirofski Rektor i Univerisitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.
- Me Vendimin nr. 168 datë 19.05.2022 ka vendosur: - Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidat për Kryetar i Bashkisë Lushnjë, zj. Ogerta Manstirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ndaj z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit "Ihsan Çabej", Lushnjë; - Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator nga ana e zj. Ogerta Manstirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nga ana e z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit "Ihsan Çabej", Lushnjë; - Konstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator nga ana e zj. Eriselda Sefa, kryetar bashkie dhe njëkohësisht kandidat për kryetar në Bashkinë Lushnjë; - T'i kërkojë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, vendosjen e sanksionit administrativ.
- Me Vendimin nr. 182 datë 30.06.2022 ka vendosur: - Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj zj. Edona Tafa Drejtor dhe njëkohësisht mjek i Qendrës Shëndetësore Rrethina, Ambulaca "Dobraç" dhe zj. Majlinda Angoni kandidat për Kryetar Bashkie Shkodër, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022; -Konstatimin e shkeljes nga ana e zj. Majlinda Angoni, kandidat për kryetar në Bashkinë Shkodër, Konstatimin e shkeljes nga ana e zj. Edona Tafa, Drejtor dhe Mjek në Qendrën Shëndetësore Rrethina, Ambulanca "Dobraç"; - T'i kërkojë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, vendosjen e sanksionit administrative.
- Me Vendimin nr. 186 datë 22.07.2022 ka vendosur: - Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj z. Xhemal Bushati, kandidat për Kryetar i Bashkisë Shkodër, z. Fatmir Juka, Përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër dhe subjektit zgjedhor "Partia Demokratike"; -Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator nga



ana e z. Xhemal Bushati, kandidat për Kryetar i Bashkisë Shkodër, pdhe z. Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër.

Në lidhje me këto vendimmarrje, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve bazuar në kërkesdat ankimore ndaj vendimeve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ka vendosur si më poshtë vijon:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 152, datë 28.04.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Pranimin e pjesshëm të kërkesës të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Sefa dhe vendosjen e sanksionit administrativ në vlerën 100000 (njëqindmijë) Lekë. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Gelardina Prodani.
- Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Drejtorit të Spitalit "Ihsan Çabej" Lushnjë, z. Perin Vogli në vlerën 2500 (dymijë e pesëqind) Lekë. Pushimin e procedimit administrativ ndaj Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Ogerta Manastirliu.
- Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Shkodër, zj. Majlinda Angoni; Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Edona Tafa, drejtore e Qendrës Shëndetësore "Rrethina, Ambulanca Dobraç. 3.
- Pushimin e procedimit administrativ lidhur me denoncimin me nr. ID unik 3671 të datës 4 Mars 2022, të raportuar në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;


Në lidhje me Vendimin nr. 168 datë 19.05.2022 (ndryshuar pjesërisht nga KAS me Vendimin nr. 19 datë 31.05.2022) është ankimuar në rrugë gjyqësore nga ana e palës paditëse Zj. Eriselda Sefa dhe Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në ligj e në prova dhe lënien në fuqi të Vendimit nr. 168 datë 19.05.2022 të KSHZ dhe Vendimit nr. 19 datë 31.05.2022 të KAS-it, përse i përket:

- Konstatimit të shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator nga ana e zj. Eriselda Sefa dhe vendosjen së sanksionit me gjobë në masën 100.000 lekë.

Nga monitorimi i ndërfaqes së raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për veprimtaritë publike të institucioneve, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, nga ana e KQZ-së janë konstatuar këto problematika:

- Aktivitetet të cilat do të kryheshin nga institucionet, nuk janë raportuar në kohë duke mos respektuar afatin 5 (pesë) ditor për raportim, të sanksionuar në nenin 4, pika 4, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator;
- Temaktika e Veprimtarisë, së kryer nga institucioni raportues, është jo e plotë dhe e përgjithshme. Mungesa e detajuar e informacionit mbi tematikën e veprimtarisë bën që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mos të ketë patur mundësinë për të klasifikuar veprimtarinë e kryer si të ndaluar ose jo.

Në lidhje me këto problematika të konstatuara, KQZ me shkresën nr.1209, datë 24.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ju ka tërhequr vëmendjen të gjashtë Bashkive që kanë marrë pjesë në zgjedhje me qëllim që, të merren masa të menjëhershme, për respektimin e dispozitave të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

Procesi i monitorimit të përdorimit të burimeve shtetërore gjatë periudhave zgjedhore, kërkon jo vetëm zbatim rigoroz të legjislacionit zgjedhor por edhe koordinim të institucioneve raportuese apo dhe institucioneve të tjera të pavarura të cilat misionin e tyre e lidhin me administrimin dhe kontrollin e te mirave materiale të shtetit. Nga ana tjetër, forcimi i kapaciteteve institucionale të KQZ-së s ai përket administrimit dhe shqyrtimit në kohë të denoncimeve për përdorimin e burimeve shtetërore gjatë fushatës zgjedhore merr rëndësi parësore. Kjo nevojë bëhet akoma edhe më shumë evidente për ndjekjen dhe verifikimin efektiv të informacioneve për të gjitha deklaratimet për veprimtaritë zyrtare në kohë.


Ndërkohë, referuar raportit të publikuar për monitorimin e zgjedhjeve parlamentare 2021, dhe më specifikisht Vendimit nr. nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëor të Zgjedhjeve, rezulton se janë marrë 61 masa administrative me gjobë për Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive (shuma varion nga 30.000 – 100.000 lekeë në varësi të shkëljes së kryer), si dhe 4 masa administrative me kthim shume KQZ-së nga ana e partive politike.

Gjithashtu, në 17 raste, i është propozuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve marrja e masës administrative, për një sërë partish politike politike me gjobë në vlera të cilat variojnë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë – 5.000 000 lekë.

Nr.	Ofruesi i Shërbimit Mediatik Audioviziv/Parti Politike	Vlera e gjobës	Shkelja e kryer
1.	News 24	100 000 (njëqind mijë) lekë	92/6, pika 6, dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor
2.	TV Ora	100 000 (njëqind mijë) lekë	92/6, pika 6, dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor
3.	Vizion Plus	100 000 (njëqind mijë) lekë	92/6, pika 6, dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor
4.	Top News	100 000 (njëqind mijë) lekë	92/6, pika 6, dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor
5.	Top Channel	100 000 (njëqind mijë) lekë	92/6, pika 6, dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor
6.	Abc News	70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë	84, pika 6, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
7.	Top Channel	70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë	84, pika 6, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
8.	TV Best	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
9.	Klan Plus	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
10.	One TV Vlora	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
11.	Top Channel	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
12.	RTV Ora	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
13.	RE-AL	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
14.	TV1 Channel	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
15.	Abc News	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
16.	Top News	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
17.	Vizion Plus	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
18.	News 24	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
19.	Klan TV	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
20.	Fax News	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor



21.	Euronews Albania	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
22.	Syri TV	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
23.	A2 CNN	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
24.	Tv 6+1 Vlorë	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
25.	Shijak TV	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
26.	Klan News	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
27.	Report TV	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
28.	One TV Ora	50 000 (pesëdhjetë mijë)	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
29.	Tv Re.AL	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
30.	TVT	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
31.	Tv UTV Education	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
32.	Tv Star Plus	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
33.	Tv Sot 7 s	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
34.	Tv Scan	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
35.	Tv Saranda	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
36.	Tv Rozafa Motiv	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
37.	Tv Premium Channe	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
38.	Tv Mati	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
39.	Tv Lobi	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
40.	Tv Kukësi	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
41.	Tv Kopliku	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
42.	Tv Klaudiana	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
43.	Tv Jug	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
44.	Tv Channel 7	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
45.	Tv Channel 1	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
46.	Tv Berati	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
47.	Tv Apollon	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
48.	Tv Antena Nord	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
49.	Tv Alpo	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
50.	Tv 6+1 Vlorë	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
51.	Tv BS s	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
52.	Shijak Tv	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
53.	Syri Tv	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
54.	One Tv Vlorë	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

55.	Glob Tv	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
56.	Era Digitalb	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
57.	Club Tv	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
58.	BBF	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
59.	ABEG Tv	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
60.	Digitalb TV	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
61.	ADTN	30 000 (tridhjetë mijë) lekë	84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor
	Parti Politike		
1.	Fryma e Re Demokratike	të kthejë në KQZ shumën prej 485.332 Data: 07.12.2022 Nr: 224 Ora: 11:00 "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet 2021" 4 (katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë	neni 88 pika 7 të Kodit Zgjedhor
2.	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	të kthejë në KQZ shumën prej 55.166,74 (pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e katër) lekë	neni 88 pika 7 të Kodit Zgjedhor
3.	Partia SocialDemokrate	të kthejë në KQZ shumën prej 1.629.360 (një milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë	neni 88 pika 7 të Kodit Zgjedhor
4.	Partia Socialiste e Shqipërisë		

NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLEVE VENDORE RINORE

- ◆ Nga 10 (dhjetë) bashki nën monitorim, 6 (gjashtë) prej tyre e kanë ngritur Këshillin Vendor Rinor me Vendim të Këshillit Bashkiak;
- ◆ Nga 10 (dhjetë) bashki nën monitorim, 3(tre) prej tyre rezulton se janë në proces përzgjedhjeje të anëtarëve të KVR-së.
- ◆ Nga 10 (dhjetë) bashki nën monitorim, 1(një) rezulton të mos e ketë nisur ende procesin e ngritjes së KVR-së.

Të dhënat e siguruar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë u ballafaquan me të dhënat e mbledhura nga përgjigjet e kthyer nga disa prej bashkive deri në këtë moment si dhe me monitorimin e kryer nga Qendra "Faktoje", kryesisht të faqeve zyrtare të bashkive si dhe stendave të njoftimit.


Interesant është për tu përmendur fakti se, pavarësisht faktit se Agjencia Kombëtare e Rinisë raporton për 6 (gjashtë) bashki nga 10 (dhjetë) që janë nën monitorim se e kanë ngritur KVR-në me Vendim të Këshillit Bashkiak, nga rezultatja e ballafaqimit të monitorimeve, del se vetëm 2 (dy) bashki e kanë ngritur Këshillin Vendor të Rinisë, bashkia Dibër dhe bashkia Lezhë por asnjëra prej tyre nuk jep informacion nëse KVR-të respektive janë konstituuar apo jo. Në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit duhet treguar kujdes sidomos me ngatërrimin e llojeve të vendimeve gjatë kryerjes së procedurave për ngritjen e KVR-së, siç janë vendimet e KB dhe Kryetarit të Bashkisë. KB ka kompetencë të miratojë kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij, ndërsa vendimi

i Kryetarit të Bashkisë për miratimin e anëtarëve të KVR-së përcakton dhe finalizimin e procesit të ngritjes së KVR-së.

PSE KA RËNDËSI?

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian paraqet një sfidë dhe një rrugëtim të gjatë për vendet e Ballkanit Perëndimor që i prek ato në formë të drejtpërdrejtë. Pavarësisht proceseve transformuese ekonomike, sociale dhe politike në të cilat këto vende janë përfshirë tashmë, një tjetër proces i rëndësishëm i ndërmarrë është Procesi i Berlinit. Që prej vitit 2014, kjo iniciativë synoi të rrisë bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe të ndihmojë integrimin e këtyre vendeve në Bashkimin Evropian. Qëllimet e Procesit të Berlinit janë të përshkruara në Deklaratën Përfundimtare të Kreut Gjerman: ***"Për të bërë progres të mëtijshëm dhe real në procesin e reformave, në zgjidhjen e çështjeve dypalëshe dhe çështjet e brendshme, si dhe në arritjen e pajtimit brenda dhe ndërmjet shoqërive në rajon"***, si dhe për të rritur ***"bashkëpunimin ekonomik rajonal dhe hedhjen e themeleve për rritje të qëndrueshme"***. Në vijim të këtij procesi një sërë Samitesh vjetore të Ballkanit Perëndimor janë mbajtur siç mund të përmenden, Forumet e Shoqërisë Civile, Forumet e Biznesit dhe Forumet Rinore.

Ky proces vuri theksin tek të rinjtë e rajonit me synimin për të krijuar mundësi të mëtijshme si dhe zhvillimin e hapësirave për promovim dhe pjesëmarrje e tyre në disa sfera të shoqërisë dhe politikëbërjes. Pjesëmarrja e të rinjve në proceset politikëbërëse në



Shqipëri por dhe në rajon mbetet e ulët si rezultat i trendeve migratore të të rinjve të rajonit, mungesës së hapësirave nxitëse të përfshirjes së tyre në këto procese, mungesës së informacionit të targetuar për këtë kategori si dhe edukimit qytetar apo mungesës së mekanizmave politikë që të mundësohet komunikimi dhe ndërveprimi i të rinjve me institucionet shtetërore. Referuar studimeve rajonale, rezulton se të rinjtë në vendet e EB6 kryesisht përballen me mungesë akses në arsim cilësor dhe punësim. Për shkak se shkalla aktuale dhe e mundshme e emigrimit e të rinjve nga EB6 vazhdon të jetë shumë e lartë, përfshirja e tyre në procese politikbërëse dhe vendimmarrëse ku ata mund të jenë pjesë e zgjidhjes të problemeve mbeten objektivat kryesore të zhvillimit dhe politikave rinore.

Çfarë vlen për t'u hulumtuar më tej, është ecuria e zbatimit të politikave rinore në vend me fokus integrimin e Shqipërisë në BE dhe masave të ndërmarra në nivel kombëtar dhe rajonal nga Shqipëria për këtë qëllim.

Të dhënat demografike të popullsisë nga INSTAT apo studime demografike për Ballkanin Perëndimor vazhdojnë e vlerësojnë Shqipërinë me një popullsi të re, ku konkretisht 23.3% e popullsisë janë të rinj. Kjo pjesë e popullsisë paraqet forcën vitale të vendit për të çuar para, ndërmarrë dhe ndryshuar norma shoqërore, sisteme dhe procese. Kjo rëndësi është shpërfaqur tashmë në politikbërje në nivelin rajonal, evropian dhe mbi të gjitha në nivelin kombëtar, ku rinia konsiderohet një ndër aktorët kryesorë dhe shtyllë e rëndësishme e shoqërisë.

Konsideruar aspiratën dhe rrugëtimin e Shqipërisë për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian, përfshirja e të rinjve si një grup shoqëror specifik me kërkesa specifike në këtë proces është kthyer në domosdoshmëri dhe kjo mund të arrihet nëpërmjet hartimit të politikave të posaçme të cilat duhet të trajtojnë në mënyrë të mëvetësishme kërkesat e të rinjve, informimit të targetuar, edukimit qytetar dhe mekanizmave specifikë që mbështesin përfshirjen e tyre në këtë proces të rëndësishëm i cili impakton në formë të drejtpërdrejtë jetën e tyre dhe shoqërinë në tërësi.


Edhe pse 92 % përqind e të rinjve shqiptarë, e

mbështesin integrimin evropian dhe anëtarësimin e Shqipërisë në BE, kjo mbështetje vijon të jetë e shoqëruar me një nivel të ulët njohurish rreth procesit dhe shpesh herë ky target grup përballlet me sfida të ndryshme që pengojnë apo ngadalësojnë aktivizimin e tyre të plotë në shoqëri dhe në politikbërje. Rinia në Shqipëri përballlet me mungesë mundësish, politika sociale dhe ekonomike si dhe mospjesëmarrjeje në vendimarrjen publike që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë jetën e tyre.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme që potenciali i të rinjve të kontekstualizohet jo vetëm në disa kapituj negociues specifik siç janë Kapitulli 19, *Politikat Sociale dhe Punësimi*, Kapitulli 25, *Shkenca dhe Kërkimi Shkencor* si dhe Kapitulli 26, *Arsimi dhe Kultura*, detyrimet që rrjedhin nga MSA, por përfshirja e tyre duhet parë në një kontekst më të gjerë dhe me një qasje ndërsektoriale në këtë proces të rëndësishëm të vendit i cili konsiderohet si objektivi gjeostrategjik dhe politik i Shqipërisë, që qëndron në thelb të politikës së brendshme dhe të jashtme të saj.

Nga ana tjetër, vetë shteti, nëpërmjet procesit të politikbërjes dhe zbatimit të këtyre politikave publike, duhet të synojë jo vetëm sigurimin e përafrimit të legjislacionit ekzistues dhe atij të ri me *"acquis communautaire"* por edhe zbatimin e duhur të këtyre politikave nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të mekanizmave dhe strukturave efikase zbatuese kombëtare e të mirëkonsoliduara. Këto mekanizma shoqërojnë procesin e integritit dhe funksionojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat e duhura, më së pari duke mundësuar krijimin e një mjedisi në të cilin të rinjtë dhe politikbërësit të ulen së bashku për të eksploruar në mënyrë konstruktive mënyrat se si mund të përmbushen prioritetet dhe nevojat e të rinjve. Ky dialog do të çonte në rritjen e zërit të të rinjve dhe shqetësimeve të adresuara në politikat përkatëse për ta.

Ajo që sot në Shqipëri mungon apo nuk ndodh në kushte optimale, është përfshirja e të rinjve në një dialog profesional për veprimtarinë dhe rezultatet e të gjithave strukturave institucionale ekzistuese apo të reja të ngritura rishtazi për zbatimin efikas të



agjendës së integritetit evropian të Shqipërisë qoftë në nivel kombëtar si dhe në nivel vendor. Të rinjtë sot kanë nevojë më shumë se kurrë për krijimin e mundësive praktike, njohëse dhe informuese për dinamikën e vetë procesit dhe sfidat për të çuar para reformat madhore në vend. Përmes debatit të shëndoshë, të rinjtë kanë mundësi të zgjerojnë informacionin, të kuptojnë rolin e mekanizmave në dispozicion, dhe kështu, të profilizojnë qëndrimet e tyre personale në "leximin" e informacionit por edhe të identifikojnë potencialin dhe rolin e tyre në kuadër të këtij procesi.

Për adresimin e këtyre çështjeve duhet që, vendimmarrësit si në nivel qendror por edhe vendor, ***(duke marrë në konsideratë se të rinjtë përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë në vend si dhe luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të vendit në kontekstin social, ekonomik dhe kulturor)***, duhet të njohin dhe vlerësojnë se angazhimi i të rinjve në shoqëri shërben si një mjet i rëndësishëm për zhvillimet demokratike në vend. Ndarjet social-ekonomike, përjashtimi social, papunësia, pamundësia për edukim profesional dhe varfëria, po prekin gjithnjë e më shumë të rinjtë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të rinjtë në të dyja nivelet e qeverisjes të nxiten, angazhohen në proceset reformuese në vend.


KUADRI RREGULLATOR DHE STRATEGJIK

Edhe pse i shoqëruar me shumë polemika gjatë procesit të diskutimit dhe miratimit të Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë" nga aktorë të ndryshëm institucionalë por edhe përfaqësues të shoqërisë civile, apo grupe të ndryshme interesi, Parlamenti në nëntor të vitit 2019 e miratoi atë me shumicën e votave. Hartimi i këtij ligji u realizua si pasojë e mungesës së një kuadri ligjor të posaçëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti. Objekti i këtij ligji është mbrojtja

e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë. Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti. Njëpërmjet miratimit të këtij ligji është synuar edhe ngritja dhe funksionimi i autoriteteve përgjegjëse/strukturave institucionale apo edhe organizmave të tjerë në nivel qendror dhe vendor me qëllim ndjekjen dhe vlerësimin e ndikimit të politikave rinore në sferën ekonomike, sociale si dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje të tyre.

Një nga çështjet që mori vëmendje të veçantë gjatë diskutimit dhe miratimit të këtij ligji ka qenë dhe shtimi i një funksioni të ri të deleguar për njësitë e vetqeverisjes vendore lidhur me krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë dhe financimin e krijimit dhe zhvillimit të infrastrukturës rinore. Ky detyrim ligjor e bën pushtetin vendor të ketë një vëmendje të shtuar tek rinia dhe përkthehet në veprime konkrete duke mandatuar stafin që do të kenë në detyrë hartimin e strategjisë lokale për të rinjtë. Në kuadër të avancimit të procesit të decentralizimit, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore luajnë një rol kyç në ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen në fuqizimin e rinisë përmes përfshirjes së të rinjve në vendimmarrjen vendore, rritjes dhe forcimit të modeleve të aktivizimit dhe advokimit të tyre nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit me pjesëmarrje aktive të të rinjve të Këshillave Vendorë të Rinisë.

Për të mundësuar zbatimin në praktikë të ligjit dhe ngritjen e strukturave institucionale, janë miratuar aktet nënligjore të cilat parashikojnë qartësisht mënyrën dhe rregullat për ngritjen e strukturave rinore në nivel qendror dhe vendor duke siguruar transparencë, përfaqësim dhe proces gjithëpërfshirës.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- VKM nr. 681, Datë 02.09.2020, "Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë"
- VKM nr. 969, datë 02.12.2020, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij"
- VKM nr. 1141, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë"
- VKM nr.274, datë 12.05.2021 "Për përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore".
- VKM nr. 833, datë 24.12.2021, "Për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore"


Ndërkohë, edhe pse këto akte kanë rreth 2 vjet që janë miratuar, është pothuajse e pamundur të gjendet informacion mbi zbatimin e tyre dhe efektet që kanë prodhuar, dhe kjo vihet re sidomos për strukturat institucionale që ligji i ka parashikuar të ngrihen në nivel vendor. Pavarësisht se nëpërmjet miratimit të kuadrit ligjor, më konkretisht zbatimit të kompetencave të parashikuara për njësitë e vetqeverisjes vendore sa i përket mbështetjes së nevojshme me burime njerëzore dhe financiare për ushtrimin e këtyre funksioneve, nuk gjendet informacion zyrtar publik në lidhje me sa Këshilla Vendore të Rinisë janë ngritur pranë 61 bashkive në vend, aktivitetin e kryer nga Këshilli Kombëtar i Rinisë që prej ngritjes së tij apo informacion mbi funksionimin e bazës së të dhënave për rininë, regjistrin elektronik për rininë (RER). Është e rëndësishme të evidentohet gjithashtu se që nga momenti i miratimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor, për sa i përket ngritjes dhe funksionimit të Këshillave Vendorë të Rinisë nuk është hartuar dhe miratuar ndonjë model i unifikuar

për ngritjen e tyre. Në këto kushte, secila bashki ka lirinë për të ndjekur procedurën më të përshtatshme të vlerësuar nga kryetari i bashkisë por e pandjekur nga një planifikim konkret në terma kohorë, buxhetorë apo institucionalë për garantimin e përfshirjes së të rinjve në vendimarrjen lokale, bazuar në numrin e të rinjve dhe shtrirjen e territorit të bashkisë.

Qeveria Shqiptare, me vendimin nr. 692, datë 26.10.2022 miratoi Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 si dhe Planin e saj të Veprimit për një periudhë 7 vjecare. Strategjia parashikon 3 qëllime politike.

Qëllimi i parë politik lidhet me garantimin e pjesëmarrjes aktive në shoqëri si dhe fuqizimin e zërit të tyre në shoqëri. Politikat ndërsektoriale rinore duhet të jenë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar. Ai synon ngritjen dhe bërjen funksionale të një sistemi të plotë mbështetës dhe organizativ për rininë në të gjithë vendin duke ju krijuar mundësi të rinjve dhe të rejave të shprehen dhe të kontribuojnë efektivisht në jetën dhe zhvillimin e komuniteteve të tyre. Pra, sipas qëllimit të politikës, planifikohet ngritja dhe funksionimi i plotë i rrjetit të Këshillave Vendorë të Rinisë, të cilët shërbejnë si rrugëlidhja ndërmjet të rinjve dhe kryetarëve të bashkive, për ti bërë të rinjtë pjesëmarrës aktivë në politikëbërjen dhe procesin e vendimarrjes kryesisht në nivel vendor. Qëllimi i dytë lidhet me pjesën e inovacionit rinor me rritjen e aftësive profesionale të të rinjve, sigurisht me një fokus të veçantë sa i përket fushës së teknologjisë dhe qëllimi i tretë ka të bëjë me pjesën e mirëqenies sociale, mendore dhe fizike, ku janë parashikuar një sërë programesh, duke filluar që nga pjesa e psikologëve në shkolla dhe këshillimi i karrierës.

Ligji nr. 75/2019 "Për Rininë" përveç funksioneve që i ngarkon organeve në nivel qendror, parashikon edhe disa funksione të rëndësishme për njësitë e vetqeverisjes vendore. Krijimi i Këshillave Vendorë të Rinisë ka për qëllim krijimin e një strukture në nivel vendor ku të rinjtë të kenë mundësinë të informohen, shkëmbejnë informacione dhe të influencojnë vendimarrjen tek Kryetari i Bashkisë



apo Këshilli Bashkiak për çështjet që lidhen me rininë. Anëtarësia në një Këshill Vendor Rinor duhet të shihet nga pjesëmarrësit si një akt i qytetarisë aktive ku interesi më i lartë për secilin anëtar duhet të jenë kauzat e të rinjve, adresimi i problematikave dhe advokimi për të dhënë zgjidhje për këto problematika. Pjesë integrale e veprimtarisë së këshillave duhet të jetë rritja e llogaridhënies për çështjet e rinisë nga pushteti vendor dhe përmirësimi i transparencës në lidhje me parashikimet buxhetore dhe reflektimin e duhur në buxhetet e bashkive, të fondeve për realizimin e të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore.

Nenet kryesore që parcaktojnë bazën ligjore për rolin e Këshillit Vendor Rinor janë neni 5 dhe neni 7 i ligjit Nr. 75/2019.

Neni 5, thekson se njësia e qeverisjes vendore duhet të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për politikën, projektet e programet në fushën e rinisë; të kontribuojë në ofrimin e veprimtarive për të rinjtë në bashkëpunim me MASR, institucione dhe autoritete të tjera vendore, duke përcaktuar standardet në ofrimin e veprimtarive rinore dhe punës me rininë.

Neni 7 nga ana tjetër, përcakton në mënyrë më të detajuar kompetencat dhe detyrimet specifike të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilave ju atribuohet detyrimi për të hartuar dhe zbatuar politikën vendore në fushën e rinisë dhe janë përgjegjëse për:

- pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
- krijimin e këshillit vendor të rinisë;
- organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;
- organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve; d) nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
- financimin e krijimit dhe të zhvillimit të


infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;

- krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
- parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin e të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
- mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

Neni 10 i ligjit Nr. 75/2019 parashikon ngritjen dhe kompetencat e Këshillit Vendor të Rinisë. Ai përcaktohet si një organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë dhe ushtron kompetencat e mëposhtme:

- këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
- bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Këshilli vendor kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar, për aq sa është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

Është e rëndësishme për tu vlerësuar në vijim se pavarësisht formës dhe kriterëve të vendosura për tu ndjekur, procesi për përzgjedhjen e kandidatëve duhet të jetë tërësisht një proces transparent dhe demokratik. Të gjithë të rinjtë të secilës njësie të vetëqeverisjes vendore duhet t'u sigurohet e drejta të përzgjidhen dhe të përfaqësojnë bashkëmoshatarët e tyre.

Në aspektin legjislativ, përveç Ligjit Nr. 75/2019 ku përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrimet e vetëqeverisjes vendore, janë së paku edhe dy ligje të tjera që prioritojnë çështjet rinore. Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" ligji organik i njësive të vetëqeverisjes vendore, rinia bëhet pjesë e përgjegjësisë dhe prioritet për NjQV për funksione që i kanë kaluar pushtetit vendor. Ndonëse nuk ka prashikime të posacme për rininë, Neni 23 përcakton funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike ku bëjnë pjesë mirëmbajtja e institucioneve arsimore apo Neni 25, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese. Neni 16 i këtij ligji garanton pjesëmarrjen publike të grupeve të ndryshme shoqërore në procesin e vendimmarrjes dhe ngritja e Këshillave Rinorë Vendorë do të personifikonte pikërisht pjesëmarrjen aktive të të rinjve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Nga ana tjetër, Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 38, pika 2, duhet të mbështetë iniciativat planifikuese buxhetore për të rejtat dhe të rinjtë në linjë me nevojat e këtij grupi, duke u udhëhequr dhe zbatuar legjislacionin në fuqi dhe dokumentat kryesorë strategjikë të hartuar për këtë qëllim.

Me qëllim monitorimin e zbatimit të Ligjit për Rininë përsa i përket detyrimit që ky ligj parashikon për njësitë e vetëqeverisjes vendore për ngritjen dhe funksionimin e Këshillave Vendorë të Rinisë, si dhe sigurimin e një panorame të përgjithshme të situatës aktuale në 10 njësi të vetëqeverisjes vendore subjekt i këtij monitorimi, Qendra "Faktoje", në datë 06.12.2022 ka dërguar kërkesë zyrtare për informacion respektivisht bashkisë Vorë, Lezhë, Dibër, Durrës, Rrogozhinë, Shijak, Krujë, Lushnjë, Kurbin dhe Shkodër.

Qendra "Faktoje" i dërgoi gjithashtu kërkesë për informacion edhe Agjencisë Kombëtare të Rinisë, si organi i cili ka si objektiv garantimin e mbrojtjes dhe promovimin e të drejtave të të rinjve, nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Nga informacioni i përcjellë nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, në kuadër të krijimit dhe funksionimit të Këshillave Vendorë Rinorë, rezultojnë të jenë hartuar dy manuale, (i) Manuali për Ngritjen e Këshillave Vendorë Rinorë, i cili është hartuar në bashkëpunim me rrjetin POP, përmes financimit të Olof Palme International Center. Ky manual shërben si udhërrëfyes i unifikuar për procesin e ngritjes dhe funksionimit të Këshillave Vendorë Rinorë. Gjithashtu, në bashkëpunim me projektin Reconnecting Albanian Youth and Society është hartuar edhe (ii) Manuali Udhëzues Operacional për Këshillat Vendorë Rinorë. Të dy këto dokumente nuk gjenden të publikuara në faqen zyrtare të AKR-së.


Në Manualin për Ngritjen e Këshillave Vendorë Rinorë pranë Bashkive, përshkruhen ndërmjet të tjerash edhe hapat proceduralë që secila prej njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të ndjekë për ngritjen dhe organizimin e KVR-ve, si më poshtë vijon.

Hapi i parë – Përgatitja e projektvendimit për ngritjen e Këshillave Vendor të Rinisë i takon

Bashkive, projektvendim që duhet të marrë miratimin e në Këshillin Bashkiak në një prej mbledhjeve mujore të tij.

Hapi i dytë - Lancimi i thirrjes për përzgjedhjen e anëtarëve të KVR-së, duke patur parasysh

kriteret e miratuara në KB. Shumë e rëndësishme është që ky proces të jetë sa më transparent dhe gjithpërfshirës që në lancimin e thirrjes për kandidatët ku të gjithë të rinjtë e zonave administrative të informohen dhe t'u jepet e drejta për t'u përzgjedhur.



Hapi i tretë – Administrimi i aplikimeve dhe shqyrtimi i tyre nga një grup pune i brendshëm i Bashkisë, i cili duhet të ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë që në fillim të këtij procesi.

Detyra e këtij grupi pune është të ndjekë të gjithë procesin duke filluar që në shpalljen e thirrjes, administrimin e aplikimeve si dhe shqyrtimin e tyre e deri në përzgjedhjen finale të anëtarëve fitues për në KVR të cilat ja con kryetarit të Bashkisë për miratim.

Hapi i katërt – Vendimi i Kryetarit të Bashkisë për emërimin e anëtarëve të Këshillit Vendor

të Rinisë. Ky do të përmbajë listën meemrat e të rinjve të përzgjedhur si anëtarë të KVR-së dhe mandatet e tyre.

Hapi i Pestë – Konstituimi i Këshillit Vendor të Rinisë. Në mbledhjen e parë të KVR-së do të formalizohet struktura e Këshillit. Mbledhjet do të drejtohen nga Kryetari i Bashkisë, i cili në të njëjtën kohë do të jetë dhe Kryetar i KVR-së. Në mbledhjen e parë të KVR-së do të përcaktohet edhe sekretari i Këshillit i cili mund të zgjidhet nga të rinjtë e KVR-së, ose mund të jetë staf i bashkisë nga sektori përgjegjës për rininë. Sekretari ka një rol kyç në KVR, pasi jo vetëm mban protokollin e mbledhjeve, por do të koordinojë dhe njoftojë anëtarët e KVR-së për të gjitha aktivitetet dhe mbledhjet që do kenë.

Marrë në konsideratë sa më lart parashikuar, evidentohet qartë se procesi i ngritjes së Këshillave Vendorë të Rinisë do të konsiderohet zyrtarisht i ezauruar me konkludimin e hapit të fundit, që lidhet me mbledhjen e parë të KVR-së ku edhe bëhet konstituimi i KVR-së.

Gjithashtu, në këtë dokument udhëzues, janë siguruar edhe modele të akteve zyrtare apo dokumenteve mbështetëse ne ndihmë të bashkive siç janë:

- Modeli i Vendimit të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së

anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”;

- Thirrje publike për Këshillin Vendor të Rinisë;
- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë për emërimin e anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë;
- Procesverbal mbledhje të Këshillit Vendor të Rinisë etj.

Ndërkohë, sa i përket të dhënave statistikore të administruara nga ana e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, evidentohet se deri në datën 13 dhjetor 2022, nga 61 bashki në total, 49 (dyzetë e nëntë) prej tyre e kanë ngritur Këshillin Vendor Rinor me Vendim të Këshillit Bashkiak.


Më konkretisht, këto bashki janë: Bashkia Berat, Dimal/Ura Vajgurore, Kucovë, Polican, Bulqizë, Klos, Mat, **Durrës, Shijak**, Belsh, Gramsh, Peqin, Përrenjas, Fier, **Lushnjë**, Mallakastër, Patos, Roskovec, Gjirokastrë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Devoll, Kolonjë, Maliq, Pustec, Kukës, Tropojë, Mirditë, Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë, Kamëz, Kavajë, Finiq, Konispol, Selenicë, Vlorë, Delvinë, Librazhd, **Kurbin**, Elbasan, Korçë, **Lezhë**, Divjakë, Skrapar, Cërrik, Has, **Dibër**.

Pra, sipas këtij informacioni, nga 10 (dhjetë) bashki nën monitorim rezulton se, 6 (gjashtë) prej tyre e kanë ngritur Këshillin Vendor Rinor me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Nga ana tjetër përmendet fakti se 5 (pesë) bashki janë në proces përzgjedhje të anëtarëve. Më konkretisht, këto bashki janë: Bashkia Dropull, Himarë, Vorë, Krujë, Rrogozhinë. Pra, nga 10 (dhjetë) nën monitorim, 3 (tre) prej tyre rezulton se janë në proces përzgjedhjeje të anëtarëve të KVR-ve.

Ndërsa 4 (katër) bashki e kanë shpallur thirrjen publike për anëtarësim në KVR. Më konkretisht këto bashki janë: Bashkia Libohovë, Këlcyrë dhe Pogradec.

Së fundmi, rezulton se 4 (katër) bashki nuk e kanë filluar ende procesin për ngritjen e KVR-ve. Këto bashki janë: Bashkia Shkodër, Vau i Dejës, Tiranë dhe



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

Sarandë. Pra, nga 10 (dhjetë) bashki nën monitorim, 1 (një) rezulton të mos e ketë nisur ende procesin e ngritjes së KVR-së.

Një përmbledhje më e gjerë dhe e detajuar të gjetjeve kryesore është organizuar në formë tabelare si më poshtë.

Për tu veçuar si dy bashki më problematike sa i përket procesit të ndjekur për ngritjen e Këshillave Vendore të Rinisë do të përmendim Bashkinë Durrës dhe Bashkinë Lushnjë:

BASHKIA DURRËS:

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga ana e Bashkisë Durrës, rezulton se Këshilli Vendor Rinor është ngritur me vendimin e Këshillit Bashkiak **nr.82 datë 28.06.2021** *“Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë”*. Nga verifikimet e kryera nga ana e Faktoje, rezulton se ky vendim është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë. Shpallja e thirrjes për herë të parë për aplikimin është kryer në faqen zyrtare të bashkisë në datë 28.08.2021. Nga data 23-27 shtator është realizuar procesi i përzgjedhjes së anëtarëve duke marrë në shqyrtim të gjitha aplikimet. Këshilli Vendor i Rinisë Durrës parashikohej të përbëhej nga 6 persona.

Kryetari i Bashkisë Durrës, Znj. Emirjana Sako, me Vendimin **nr.133, datë 14.12.2021**, ka vendosur emërimin e anëtarëve të KVR-së. Sipas këtij vendimi, mandati i anëtarëve të KVR-së parashikohet të jetë 2-vjecar me të drejtë riemërimi. Nga verifikimet e kryera nga Faktoje, ky vendim gjendet i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.

Bashkia Durrës, sipas informacionit zyrtar të përcjellë, ka shpallur një thirrje të dytë në datë 12.09.2022, ku parashikohet që KVR do të përbëhet nga 13 anëtarë. Thirrja e dytë për anëtarët e rinj të Këshillit u publikua në faqen instagram të krijuar nga Këshilli Vendor Rinor shoqëruar me një link për të plotësuar formularin e aplikimit në google form. Në datë 25.10.2022 është finalizuar me sukses përzgjedhja


e 10 anëtarëve të rinj dhe momentalisht KVR e re aktualisht është në fazën e përgatitjes së kostitimit.

Nga analiza e fakteve dhe rrethanave sa më sipër, sjellim në vëmendje dispozitën ligjore në pikën 2 të nenit 10 të ligjit nr. 75/2019, e cila parashikon se: *“2. Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë”*.

Së pari, është e paqartë arsyeja se përse Bashkia Durrës ka vendosur të shpallë një thirrje të dytë për anëtarë të KVR-së ndërkohë që ka pasur një KVR ekzistuese të përbërë nga 6 anëtarë në përputhje me parashikimet ligjore të cilat përcaktojnë numrin 6 të anëtarëve si numrin maksimal që mund të ketë përbërja e KVR-së në Bashki. Gjithashtu, nuk sqarohet se bazuar mbi cilin vendim të Këshillit Bashkiak është kryer thirrja e dytë, kjo pasi vendimi i KB-së nr.82 datë 28.06.2021 *“Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë”*, e ka përmbushur “misionin” e tij dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm edhe për procese të tjera përzgjedhëse vijuese të cilat kanë si qëllim ngritjen nga e para të KVR-së.

Së dyti, referuar vendimit nr.133, datë 14.12.2021 të kryetares së bashkisë, mandati i anëtarëve të KVR-së parashikohet të jetë 2-vjecar, çfarë do të thotë që ata duhet të qëndrojnë në detyrë deri në datë 14.12.2023, me përjashtim të rasteve kur anëtari gjendet para kufizimeve ligjore si humbja e zotësisë juridike për të vepruar me vendim gjyqësor apo dhënia e dorëheqjes. Nuk kuptohet qartë se cilat kanë qenë shkaqet që e kanë detyruar bashkinë Durrës të procedojë me shpallje të thirrjes së dytë ku përcaktohet se KVR do të përbëhet nga 13 anëtarë, në tejkalim të cdo parashikimi ligjor.

Së fundi, në informacionin e përcjellë nga ana e bashkisë përmendet fakti se në datën 25.10.2022 ka përfunduar me sukses përzgjedhja e 10 anëtarëve (nga 13 të kërkuar), për në KVR por nuk na është



vënë në dispozicion vendimi i Kryetares së Bashkisë për miratimin e këtyre anëtarëve. Ky vendim nuk gjendet i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë. Përsëri, gjendemi në kushtet kur procesi i ngritjes së KVR-së nuk është finalizuar me vendimin e Kryetares së Bashkisë për emërimin e anëtarëve të KVR-së.

BASHKIA LUSHNJE:

Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ana e Bashkisë Lushnje rezulton se Kryetarja e Bashkisë nëpërmjet vendimit nr.316, datë 20.04.2022 ka emëruar anëtarët e KVR-së. Ndërkohë që pranë Faktoje është dërguar jo i plotë vendimi i Këshillit Bashkiak i cili ka miratuar kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të bashkisë, rezultoi se Këshilli Bashkiak nëpërmjet vendimit nr. 88, datë 24.11.2021 ka miratuar kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij, publikuar në faqen zyrtare të bashkisë. Në vijim të këtij vendimi, janë kryer dy shpallje të thirrjeve për aplikim për anëtar të KVR-së, përkatësisht në datë 31.12.2021 dhe 28.02.2022, të dyja të kryera në faqen e FB të bashkisë. Në faqen zyrtare të bashkisë nuk gjendet asnjë informacion i publikuar në lidhje me thirrjet.

Ndërkohë që, Këshilli Bashkiak nëpërmjet vendimit nr. 09, datë 31.01.2022, ka shfuqizuar vendimin e mëparshëm të KB-së nr. 88, datë 24.11.2021 me arsyetimin se ky vendim merrej për shkak të mosplotësisht të shkronjës "k" të nenit 54 të Ligjit Nr. 139/2019 "Për Vetqeverisjen Vendore", i ndyshuar dhe mbështetur në pikën 3 të nenit 113 dhe pikën 2 të nenit 117 të Kodi i Procedurave Administrative. Pika "k" e nenit 54 të Ligjit 139/2019 parashikon se: **"Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:...k)**


miraton norma, standarde e kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik". Ky vendim gjendet i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.

Referuar parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Në rastin konkret Këshilli Bashkiak ka shfuqizuar kryesisht aktin e nxjerrë nga vetë ky organ, vendimin nr. 88, datë 24.11.2021, nëpërmjet vendimit nr. 09, datë 31.01.2022, që do të thotë që ky akt shfuqizimi rregullon pasojat juridike për të ardhmen, pra pas datës 31. 01.2022.

Referuar postimeve në faqen e FB të bashkisë Lushnjë, rezulton që thirrja e dytë për aplikim për anëtar të KVR-së, është publikuar në datë 28.02.2022, pra pas marrjes së vendimit për shfuqizimin e vendimit i cili miratonte kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij. Në këtë thirrje vihet re se nuk ka të përcaktuar afate konkrete në lidhje me dorëzimin e aplikimeve apo edhe përmbylljes së procesit të përzgjedhjes së anëtarëve.

Bazuar në informacionet e lartpërmendura si dhe në kushtet kur Bashkia Lushnjë nuk ka depozituar informacionin e duhur dhe të saktë në lidhje me këtë proces, është e vështirë për të konkluduar nëse Bashkia Lushnjë ka përfunduar procesin e përzgjedhjes së anëtarëve për Këshillin Vendor të Rinisë apo jo, si dhe a ka zgjidhur këtë ngërç ligjor për të siguruar vijueshmërinë e duhur të procesit.

Monitorimi i rregullt dhe periodik mbi zbatimin e detyrimeve ligjore për ngritjen dhe funksionimin e strukturave vendore të Këshillave Rinor Vendor në çdo bashki të vendit, do të shërbente në fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse por dhe në rritjen e potencialit të përfshirjes së tyre në procesin e integritetit evropian.




RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE NË MONITORIM

KRIJIMI I KËSHILLAVE VENDORË TË RINISË NË BASHKI NË PËRPUTHJE ME PARASHIKIMET E NENIT 7, PIKA 1/B, I LIGJIT NR. 75/2019 "PËR RININË"				
	Të dhënat e siguruar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë	Të dhënat e siguruar nga Bashkia	Të dhënat nga Monitorimi i "Faktoje"	Statusi aktual
Bashkia Vorë	Në proces përzgjedhje te anëtareve	Thirrje publike për anëtarësim në KVR. Afati i aplikimit deri në datë 08.11.2022. Bashkia raporton se momentalisht është në proces përzgjedhje te anëtareve.	Në faqen zyrtare të bashkisë gjendet i publikuar formulari i aplikimit për në KVR, postuar në datë 12.10.2022. Nga verifikimi i vendimeve të KB për vitin 2022 nuk rezultojnë të ketë asnjë vendim i cili të miratojë kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.	Bazuar në informacionin e deritanishëm, rezultojnë se Bashkia Vorë nuk e ka ngritur Këshillin Vendor të Rinisë.
Bashkia Lezhë	KVR i ngritur me Vendim të Këshillit Bashkiak	-Thirrje publike për anëtarësim në KVR, datë 15.07.2022; - Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 515, datë 04.11.2022 "Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë"	-Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 44, datë 27.04.2022 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij"; - Thirrje publike për anëtarësim në KVR, datë 15.07.2022.	Vendim i kryetarit të bashkisë për emërimin e anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë Nr. 515, datë 04.11.2022 nuk gjendet i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë. Bashkia nuk jep informacion në lidhje me procesin e konstituimit të KVR-së, nëse ka ndodhur ose jo. KVR në Bashkinë Lezhë konsiderohet si i ngritur por jo funksional.



Bashkia Dibër	KVR i ngritur me Vendim të Këshillit Bashkiak	- KVR i ngritur me vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 75, datë 16.09.2022 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij"; - Vendim i kryetarit të bashkisë për emërimin e anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë nr. 516, datë 07.12.2022.	- Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 75, datë 16.09.2022 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij"; - Thirrja publike për anëtarësimin në Këshillin Vendor të Rinisë e publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë (afati për përzgjedhjen e kandidatëve, data 4 nëntor 2022); - Në faqen zyrtare të internetit të bashkisë nuk ka informacion për vijimin e procesit të përzgjedhjes finale të anëtarëve fitues për në KVR dhe as vendim të Kryetarit të Bashkisë për miratimin e anëtarëve të KVR-së.	Vendim i kryetarit të bashkisë për emërimin e anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë nr. 516, datë 07.12.2022 nuk gjendet i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Dibër. Bashkia nuk jep informacion në lidhje me procesin e konstituimit të KVR-së, nëse ka ndodhur ose jo. KVR në Bashkinë Dibër konsiderohet si i ngritur por jo funksional.
Bashkia Durrës	KVR i ngritur me Vendim të Këshillit Bashkiak	- KVR i ngritur me vendim të Këshillit Bashkiak nr.82, datë 28.06.2021 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë"; - Vendim i Kryetares së Bashkisë nr.133, datë 14.12.2021, për emërimin e anëtarëve të KVR-së; - Shpallur thirrje e dytë në datë 12.09.2022, finalizuar në datë 25.10.2022	Shpallja e thirrjes për aplikim për Këshillin Vendor Rinor, Bashkia Durrës bashkë me formularin e aplikimit, kryer në faqen zyrtare të bashkisë në datë 28.08.2021.	Problematiche ngritja dhe funksionimi i KVR-së Durrës sipas shpjegimeve të dhëna më sipër në pjesën shpjeguese të raportit. Nuk është i qartë statusi aktual i KVR në bashkinë Durrës.
Bashkia Rrogozhinë	Në proces përzgjedhje të anëtarëve	-Broshurë njoftuese për thirrjen publike të Këshillit Vendor të Rinisë; - Shkresë Nr.4278 Prot , datë 18.10.2022 për thirrjen publike mbi ngritjen e Këshillit Rinor në Bashkinë Rrogozhinë; Bashkia raporton gjithashtu se ndodhet në fazën e përzgjedhjes së kandidatëve.	Nga verifikimet e kryera, në faqen zyrtare të bashkisë nuk ka asnjë informacion të publikuar në lidhje me procesin e ngritjes dhe funksionimit të KVR-së, përfshirë këtu Vendimin e Këshillit Bashkiak "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij" si dhe thirrjen publike për të aplikuar për anëtar i KVR-së. Nga ana e bashkisë nuk është vënë në dispozicion asnjë link i faqes zyrtare ku të shfaqet publikimi i thirrjes publike.	KVR në bashkinë Rrogozhinë nuk konsiderohet i ngritur.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

Bashkia Shijak	KVR i ngritur me Vendim të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shijak nuk ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion të "Faktoje", datë 06.12.2022	Nga verifikimet e kryera, në faqen zyrtare të bashkisë nuk ka asnjë informacion të publikuar në lidhje me procesin e ngritjes dhe funksionimit të KVR-së	KVR në bashkinë Shijak nuk konsiderohet i ngritur.
Bashkia Krujë	Në proces përzgjedhje te anëtareve	Bashkia Krujë nuk ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion të "Faktoje", datë 06.12.2022	Nga verifikimet e kryera, në faqen zyrtare të bashkisë nuk ka asnjë informacion të publikuar në lidhje me procesin e ngritjes dhe funksionimit të KVR-së	KVR në bashkinë Krujë nuk konsiderohet i ngritur.
Bashkia Lushnjë	KVR i ngritur me Vendim të Këshillit Bashkiak	Informacion i paplotë në lidhje me vendimin e KB i cili ka miratuar kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë. Me vendimin nr.316, datë 20.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë, janë emëruar anëtarët e KVR-së.	Vendim i KB nr. 88, datë 24.11.2021 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij" publikuar në faqen zyrtare të bashkisë; Dy shpallje të thirrjeve për aplikim për anëtar të KVR-së, datë 31.12.2021 dhe 28.02.2022, të kryera në faqen e FB të bashkisë. Në faqen zyrtare të bashkisë nuk gjendet asnjë informacion i publikuar. Vendim i KB nr. 09, datë 31.01.2022, nëpërmjet të cilit shfuqizohet vendimi i mëparshëm i KB-së nr. 88, datë 24.11.2021, i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.	Nga informacioni i deritanishëm, konsiderojmë se KVR-ja, Bashkia Lushnjë nuk mund të konsiderohet e ngritur.
Bashkia Kurbin	KVR i ngritur me Vendim të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kurbin nuk ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion të "Faktoje", datë 06.12.2022	Nga verifikimet e kryera, në faqen zyrtare të bashkisë nuk ka asnjë informacion të publikuar në lidhje me procesin e ngritjes dhe funksionimit të KVR-së. Gjithashtu, faqja e publikimit të vendimeve të Këshillit Bashkiak nuk nxjerr asnjë të dhënë mbi vendimet përkatëse për vitin 2021 dhe 2022.	KVR në bashkinë Kurbin nuk konsiderohet i ngritur.
Bashkia Shkodër	Nuk është filluar ende procesi i ngritjes së KVR-së	-Në proces ngritjeje; Ekziston një qendër rinore ekzistuese "Atelie" pranë bashkisë e cila është pjesë e rrjetit të qendrave komunitare "Për familjen"; -Hartimi i draft projekt-vendimit "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij" për aprovim në KB.	Nuk ka asnjë informacion në faqen zyrtare të internetit.	Informacioni i siguruar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë nuk përputhet me informacionin e siguruar nga vetë bashkia. KVR nuk është ngritur në Bashkinë Shkodër.

ANEKS 1

Kërkesa për informacion dërguar 10 bashkive të monitoruara

KËRKESË

28.12.2021

KËRKUES: Emër mbiemër

Adresa:

Email:

DREJTUAR: Bashkisë _____

BAZA LIGJORE:

- ◆ Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
- ◆ Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike
- ◆ Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- ◆ Ligji nr.119 dt. 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit"

Në bazë të parashikimeve ligjore të akteve të renditura në bazën ligjore të mësipërme, kërkoj ju lutem informacionin dhe dokumentacionin përkatës për pyetjet më poshtë:

- 1 A është konsultuar me publikun Buxheti Vjetor 2020 dhe 2021 i Bashkisë? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve


të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

- 2 A është konsultuar me publikun paketa e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2020-2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

- 3 A është konsultuar me publikun tjetërsimi i pronave të Bashkisë për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

- 4 A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

- 5 A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Komisioneve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

- 6** A shfaqen në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike, njoftime për organizimin e Dëgjesave Publike nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre dëgjesave, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku parashikohet "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një

kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit, kërkoj dokumentacionin përkatës që mbështet realizimin e procesve të referuar në pyetjet e mësipërme.

Në bazë të nenit 15, të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku parashikohet **"Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe"** lutem përcjelljen e informacionit dhe dokumentacionit përkatës brenda këtij afati ligjor.

Për çdo komunikim tjetër për sqarimin e kërkesës së paraqitur, mund të më kontaktoni edhe në emailin: **email: emermbiemer@email.com**

Duke ju falenderuar,

Emër Mbiemër

Ky raport u mbështet nga National Endowment Democracy (NED)

Raporti u punua nga:

Enkelejd Musabelliu dhe Erisa Proko